

مترجمة باللغة الألبانية
وقف لله تعالى

Përkthyer në gjuhën shqipe
Shpërndahet Falas

هذا هو الإسلام Ky është islami

Tre Parimet

Katër Parimet

Anuluesit e Islamit

هذا هو الإسلام (اللغة الألبانية) Ky është islami



attasseel attasseelalelm attasee.alemi attasseelalelm1 attasseelalelm1



Email: islamtorrent@gmail.com

site: www.saarhan.net

site: www.attasseel-alemi.net/ar/

سارحان
الموقع الرسمي للشيخ

Autor: Muhamed ibn Sulejman Et-Temimi

Shpjegues: Hejthem ibn Muhamed Serhan
Ligjerues pranë xhamisë Profetike, Medine

Përshtati në gjuhën shqipe: Esat Rexhepi

SHPJEGIMI I PYETJEVE TË VARRIT

Shejh

Hejthem ibn Muhamed Serhan

Ligjërues pranë xhamisë së Profetit ﷺ, Medinë.

Përktheu
G. Myrteza

Reçensoi
Esat Rexhepi

Të gjitha lavdërimet dhe falenderimet i takojnë Allahut, Atë e lavdërojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë.

Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e vetes dhe e veprave tona. Këdo që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë dhe këdo që Ai e devijon askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut i Cili është i vetëm, pa partnerë, dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i Dërguar i Tij.

HYRJE

Autori i këtij libri

Dijetari i islamit dhe ripërtëritësi i thirrjes në Teuhid (njëshmëri të Allahut), imam Ebu Husejn Muhammed ibn Sulejman Temimi. U lind më 1115H dhe vdiq në 1206H.

PSE E MËSOJMË TEUHIDIN?

Allahu na krijoi për këtë arsye.

Allahu nuk pranon asnjë vepër pa të.

Asnjë nuk do të hyjë në Xhennet përveç njësuesve.

Ai (teuhidi) bën që veprat e mira të shumëfishohen.

Është një mjet për të shlyer mëkatet.

Teuhidi çon drejt sigurisë së vazhdueshme, udhëzimit dhe ëmbëlsisë së besimit.


Është një mjet për të arritur qetësi.

Teuhidi është një mjet për të arritur ndërmjetësimin e Pejgamberit ﷺ

Pse duhet të mësojmë këtë libër fillimisht


Paraardhësit tanë të drejtë dhe dijetarët e Islamit filluan me këtë libër të dobishëm për shkak të dobive të mëdha që përmban. Si rezultat, është bërë libri kryesor me të cilin një kërkues i diturisë fillon udhëtimin e tij dhe ndërton mbi të pjesën tjetër të diturisë islame, andaj ne ndjekim rrugën e dijetarëve tanë në këtë plan program. Për më tepër, ky libër është jashtëzakonisht i rëndësishëm për muslimanët e thjeshtë për shkak të asaj që përmban ky libër prej themeleve të mëdha të cilat duhet ti besojë me një bindje të fuqishme e cila nuk përmban dyshim.

Librat e autorit dallohen për:



CILAT JANE TRE PARIMET THEMELORE

Në përmbledhje, ato janë tri pyetjet e varrit




CILAT JANE FRYTET E MËSIMIT TË TRE PARIMEVE THEMELORE


Nëse i mëson këto tre parime themelore, vepron sipas tyre, i thërret të tjerët në to dhe duron gjatë vështirësive (në dituri, vepër dhe thirrje) ju - me lejen e Allahut - do t'i përgjigjeni pyetjeve të varrit .




KY LIBËR NDAHET NË PESË PJESË



1. KATËR ÇËSHTJET E RËNDËSISHME



2. TRI ÇËSHTJET E RËNDËSISHME




3. RËNDËSIA E MËSIMIT TË TEUHIDIT

Përgjigje e pyetjes: Pse e mësojmë Teuhidin?

4. TRE PARIMET THEMELORE

Në përmbledhje, ato janë tri pyetjet e Varrit



5. PËRMBYLLJA

SË PARI, KATËR ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

"Në emër të Allahut, Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit **(1)**. Dije, Allahu të mëshiroftë **(2)** se është e nevojshme për ne të mësojmë katër çështjet të rëndësishme"

E para: dituria*, e ajo është:

Njohja e Allahut, njohja e Profetit të Tij ﷺ dhe njohja e fesë islame me argumente.

E dyta: Të vepruarit me të **(3)**.

(1) Arsyet që autori fillon me emrin e Allahut:

1. Ndjekja e shembullit të Librit të Allahut dhe të Profetëve - paqja qoftë mbi ta -.

2. Ndjekja e shembullit të paraardhësve tanë të drejtë nga dijetarët e islamit; ata gjithmonë fillonin librat e tyre në emër të Allahut.

3. Kërkim i bekimit (rritje në mirësi) prej emrit të Allahut më Fisnikut.

(2) Zakonisht, autori fillon duke bërë lutje për nxënësit e dijes, dhe i kërkon Allahut të ketë mëshirë për ta. Kjo tregon:

1. Mëshiren e dijetarëve të Sunetit për nxënësit e dijes

2. Islami, në origjinën e tij, është ngritur mbi mëshirë.

- Dituria është të njohësh të vërtetën me argumente; është e kundërta e injorancës.

(3) Është thënë sa i përket lidhjes midis ditorisë dhe veprës:

"Dituria thërret në vepër, nëse vepra i përgjigjet ajo ngel, përndryshe dituria ikën".

Kështu; nuk përfiton ai që posedon dituri derisa të veprojë sipas saj. Për më tepër, nëse një person mëson diturinë, ai duhet të veprojë sipas saj; përndryshe, poseduesi i saj do t'i përngjasojë çifutëve, sepse ata kanë dituri; megjithatë, nuk veprojnë sipas saj. Allahu na njofton se **"e njohin atë (Muhamedin) siç i njohin bijtë e tyre"** (Kur'ani 2: 146).

Të parëve që do të hyjnë në zjarr janë tre, midis tyre është përmendur dijetari i cili ka mësuar diturinë dhe nuk ka vepruar me të.

Siç ka thënë poeti:

'Dhe dijetari që nuk vepron me diturinë e tij do të dënohet para adhuruesit të idhujve'.

THIRRJA NË RRUGË TË ALLAHUT KA KUSHTE:

1. Duhet të jetë singlerisht për Allahun, Më të Lartin.

2. Duhet të bazohet në diturinë që e ka ligjësuar Allahu.

3. Duhet të bëhet me mençuri, (urtësi) dhe durim.

4. Të kihet parasysh gjendja e atyre që po thirren.

E treta:

Thirrja në të.

Dëshmi për këto kushte është ajeti i Kur'anit:

"Thuaj: Kjo është rruga ime, ftoj për tek Allahu me dije dhe argumente të qarta, unë dhe ata që më ndjekin, dhe i Lartësuar është Allahu, unë nuk jam idhujtarëve!" (Kur'an 12: 108).

"Thuaj, Kjo është rruga ime " Ajo çfarë sinjalizohet këtu është ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari ﷺ (legjislacioni i tij).

"Ftoj për tek Allahu " Një person që fton për tek Allahu është i singertë që vetëm dëshiron të lidhë njerëzit me Krijuesin e tyre.

"Me dije dhe argumente te qarta" do të thotë me dituri, e ajo përfshin diturin për:

1. Legjislacionin

2. Ata që ftohen

Sikur autori - Allahu e mëshiroftë - është duke thënë:

"Nëse mëson dhe vepron, atëherë të bëhet e detyrueshme që të jesh në rrugën e Profetit ﷺ dhe të shokëve të tij siç thotë Allahu: **"Thuaj: kjo është rruga ime, unë thërras tek Allahu me dije dhe argumente te qarta, unë dhe ata që më ndjekin "**. Kështu pra, është domosdoshmëri shpërndarja e diturisë.

E katërta:

Durimi gjatë vështërsive në të **(1)**. Argument është thënia e Më të Lartit:

“Pasha kohën! Me të vërtetë ,njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besojnë dhe bënë punë të mira, dhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën dhe të jenë të durueshëm.”
[El Asr, 1-3]. **(2)**

(1) Pas thirrjes, autori përmendi sprovat dhe vështirësitë, sikur ka dashur të thotë:

"Ai që e merr këtë rrugë, do të ketë vështirësi ashtu siç kishin Profetët dhe të Dërguarit prandaj është e domosdoshme të kesh durimin".

Durimi

**Kuptimi
gjuhësor:**

Vetëpërmbajtje

Fetarisht:

Vetëpërmbajtje në veprimin e disa gjërave dhe në largimin prej disa të tjerave.

Ibn Kajimi - Allahu e mëshiroftë - e ndan durimin në tre kategori:

1. Durim në bindjen ndaj Allahut derisa të kryhet detyra.

2. Durim ndaj mëkateve derisa të largohet prej tyre.

3. Durimi në atë që Allahu sprovon prej vështirësive.

(2) Pas përmendjes së katër parimeve, autori citon argumentin nga Kur'ani, e ajo është Sureja el Asr. Autori gjithmonë ndjek çështjet me argumente. Pse?

1. Të përgatisë studentin si një ndjekës i argumentit dhe jo si një ndjekës i verbër i mendimeve.

2. Me qëllim që studenti të njohë argumentet kur këshillon ata që e kundërshtojnë.

3. Të përgatisë studentin që t'i nxjerrë vendimet nga argumentet, bazuar në parime të sakta.

(1) Qëllimi i **imam Shafiut**- Allahu e mëshiroftë - është se kjo sure është e mjaftueshme për t'iu ngritur argumenti robit, në mënyrë që ata të mësojnë, veprojnë, të thërrasin të tjerët dhe të praktikojnë durimin.

Çfarë mendon pas kësaj në lidhje me pjesën tjetër të sureve të Kur'anit?! I tërë Kur'ani është plot argumente.

(2) **Imam Buhariu** filloi një nga kapitujt e librit të tij me titullin:

"**Kapitulli: Dituria i paraprin fjalës dhe veprës**" dhe përmendi argumentin për të. Prandaj, është e domosdoshme dituria para se të flasësh ose të bësh ndonjë veprim. Nuk është korrekte të bëjmë veprime pa dituri, përndryshe do të imitonim të krishterët.

Imam Shafiu - Allahu e mëshiroftë – ka thënë:

"Sikur Allahu të mos zbriste argument për krijesat e Tij përveç kësaj *sureje*, ajo do të ishte e mjaftueshme për ta" **(1)**.

Buhariu - Allahu e mëshiroftë - ka thënë:

"Kapitull: Dituria i paraprin fjalës dhe veprave" argument për këtë është thënia e Allahut:

" Dije që La ilahe il-IAllah (askush nuk është i denjë të adhurohet përveç Allahut) dhe kërko falje për mëkatin tënd". Kështu, ai përmendi diturinë para fjalës dhe veprave". **(2)**

SË DYTI, TRI ÇËSHTJET E RËNDËSISHME

"Dije, Allahu të mëshiroftë që është e detyrueshme për ç' do musliman dhe muslimane që të mësojë tri pika dhe të veprojë me to" (1)

(1) Autori filloi këtë paragraf duke bërë lutje për nxënësin e diturisë / lexuesin.

Autori lutet për nxënësin e diturisë në këtë libër tri herë; në fillim të katër parimeve të rëndësishme, në fillim të tre parimeve të rëndësishme, dhe gjithashtu kur thotë: "Dije, Allahu të drejtoftë në bindjen e Tij se Hanifija është rruga e Ibrahimit".

HYRJE E TRI ÇËSHTJEVE TË RËNDËSISHME:

Teuhid

Gjuhësisht:

Të veçosh diçka.

Fetarisht:

Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësit e Tij.

TEUHIDI NDAHET NË TRE KATEGORI

1. Teuhidi i Zotërimit:
Të veçosh Allahun me veprimet e Tij ose thënë ndryshe: veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i Universit.

2. Teuhidi i Adhurimit:
Të veçosh Allahun me të gjitha adhurimet.

3. Teuhidi i Emrave dhe Cilësive* të Allahut:
Veçimi i Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Vetën në Librin e Tij ose në thënie të Dërguarit të Tij ﷺ. Kjo bëhet duke pohuar atë që Ai ka pohuar për Vetën dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Vetën pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasuar me cilësitë e krijesave.

*Emrat dhe Cilësitë janë të kufizuara vetëm në atë që është transmetuar në Kur'an dhe Sunet (të saktë).

- Kjo bëhet duke pohuar atë që Allahu ka pohuar për Vetën e Tij në Librin e Tij ose atë që i Dërguari i Tij ka pohuar për Të në thëniet e tij. Gjithashtu duke mohuar atë që Allahu e ka mohuar për Vetën e Tij në Librin e Tij ose që i Dërguari i Tij e ka mohuar për Të. Për shembull: **"Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi"**, ose **"Neve nuk na ka kapluar ndonjë lodhje"**, kjo bëhet duke mos shtrembëruar kuptimin e tyre, duke mos i mohuar, duke mos ju dhënë formë të caktuar apo përngjasuar me të krijesave.

Pika e Parë: Allahu na ka krijuar, na ka furnizuar dhe nuk na ka lënë pas dore, përkundrazi, Ai na ka dërguar një lajmëtar. Kushdo që i bindet atij, do të hyjë në Xhennet dhe kushdo që nuk e dëgjon atë, do të hyjë në Zjarr. Argument për këtë është thënia e Allahut: **"Në të vërtetë ju kemi sjellë një të dërguar dëshmitar mbi ju, ashtu siç i çuam një të Dërguar Faraonit, por Faraoni e kundërshtoi të dërguarin, andaj e dënuam me një dënim të rëndë"** (1)
(Kur'an 73:15-16).

PËRMBLEDHJA E TRI ÇËSHTJEVE TË RËNDËSISHME

1. Teuhidi i Zotërimit dhe Teuhidi i Emrave dhe Cilësive.

2. Teuhidi i adhurimit

3. Distancimi prej shirkut dhe praktikuesve të tij

(1) Në pikën e parë, autori - Allahu e mëshiroftë - pohon

Teuhidin e Zotërimit dhe Teuhidin e Emrave dhe Cilësive:

"Allahu na krijoi, kështu që Ai është el Khalik (Krijuesi)" dhe na furnizoi

"kështu që Ai është Er-Razik (Furnizuesi)", **"dhe Ai nuk na ka lënë pas**

dore" d.t.th nuk na ka lënë pa na kushtuar rëndësi, duke mos na urdhëruar dhe ndaluar.

ARSYEJA QË ALLAHU KA DËRGUAR PROFETË

1. Për t'ia ngritur argumentin krijesave:
"Ne nuk dënojmë askënd derisa të dërgojmë një të dërguar"

2. Si mëshirë:
"Ne nuk të kemi dërguar ty veçse si mëshirë për botët".

Pika e dytë: Allahu nuk është i kënaqur që ndokush të shoqërohet me Të në adhurimin e Tij; qoftë një engjëll i afërt tek Allahu, apo një i dërguar.

Argument për këtë është thënia e Allahut:

"Vendfaljet i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Tij "
(Kur'an 72:18)

Pika e dytë afirmon adhurimin vetëm për Allahun, Më të Lartin.

Autori - Allahu e mëshiroftë - thotë: *"Allahu nuk është i kënaqur që dikush tjetër të adhurohet me Të"*. "dikush tjetër" është në trajtën e pashquar kështu që përfshin gjithçka; profetët, njerëzit e drejtë, xhinët, engjëjt, të devotshmit apo të tjerët.

Argument për këtë është thënia e Allahut, Më të Lartit:

"Vendfaljet i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Tij ."

Egzistojnë tre mendime në lidhje me kuptimin e fjalës 'Mesaxhid '(vendfalje) -, edhe pse mund të jenë të gjitha të sakta :


1. Xhamitë që janë ndërtuar që Allahu të adhurohet në to.

2. Pjesët e trupit me të cilat bëjmë sexhde.

3. E gjithë toka;
"Toka është bërë për mua vendfalje dhe vendpastrim"
(Bukhari).

"... kështu që mos iu lutni askujt, krahas Allahut" - "askujt"
përfshin gjithkënd dhe gjithçka.

Në pikën e tretë, autori sqaron distancimin prej shirkut dhe atyre që e praktikojnë atë.



1. Me Zemër:

Duke i urryer jobesimtarët, ceremonitë dhe festat e tyre; në formë të veçantë shirkun dhe bidatet (shpikjet) e tyre në fe.

2. Me Fjalë:

"Unë jam i pastër (larg) nga ajo që ju adhuroni ". (43:26)

"O ju jobesimtarë, unë nuk adhuroj atë që ju adhuroni, dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, unë nuk do të jem adhurues i atyre që ju i adhuroni, As ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time" (109:1-6)

3. Me vepra:

Duke mos marrë pjesë në festat, ceremonitë, veshjet apo besimet e tyre.

Pika e Tretë: Kushdo që i bindet të Dërguarit dhe e veçon Allahun me të gjitha adhurimet, nuk është e lejueshme që ti dojë ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij; edhe nëse janë nga të afërmit e tyre, argument për këtë është thënia e Allahut:

---- per tu pare perkthimi ----

"Nuk gjen njerëz që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, e të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre, ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ai, në zemrat e tyre ka mbjellë besimin dhe me shpalljen e Vet i ka fuqizuar ata, dhe Ai do t'i shpie ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta, por edhe ata do të jenë të kënaqur ndaj Tij. Ata janë pala e Allahut dhe vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese".

(Kur'an 58:22).

SË TRETI, RËNDËSIA E MËSIMIT TË TEUHIDIT

"Dije, Allahu të drejtoftë në bindjen ndaj Tij, që feja e pastër e Ibrahimit, alejhi selam është:

Të adhurosh vetëm Allahun, duke e bërë fenë singërisht për Të, me këtë Allahu i ka urdhëruar të gjithë njerëzit dhe për këtë i ka krijuar ata. Allahu i Lartësuar thotë:

"Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit, përveçse të më adhurojnë"

(Kur'an 51:56)

Kuptimi i shprehjes **"Të më adhurojnë"** është **"Të më veçojnë Mua në adhurim."**

Çështja më e madhe të cilën Allahu e ka urdhëruar është Teuhidi, dhe teuhid do të thotë:

"Të veçojmë Allahun me të gjitha adhurimet". (1)

Çështja më e madhe të cilën e ka ndaluar është shirku, e shirku është:

"T'i lutesh të tjerëve së bashku me Të".

Argument për këtë është thënia e Tij:

"Adhuroni Allahun dhe mos shoqëroni asgjë me Të "

(Kuran 4:36)

Hanifi

Gjuhësisht:

Marrur nga shprehja "Hanef" që do të thotë "Anim".

Fetarisht:

Është feja e cila është e distancuar nga shirku, e orientuar nga Singëriteti, Teuhidi dhe Besimi

"Kaniten Lilahi, Hanifen"

që do të thotë t'i përkushtohesh Allahut dhe të qëndrosh larg shirkut, pra Hanifi është ai person që përherë i përkushtohet Teuhidit dhe qëndron larg shirkut.

(1) Autori sqaron arsyen pse mësojmë Teuhidin, rëndësia e të cilit është përmendur dhe më lart.

PËRKUFIZIMI I TEUHIDIT

Gjuhësisht:

Të veçosh diçka

Fetarisht : Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësit e Tij.

Autori thotë: kuptimi i **"për të më adhurosh Mua"** është **"që të më veçojnë Mua në adhurim"**. Kjo është thënia e ibn Abbasit - Allahu qoftë i kënaqur me të - kur tha: "ç'do herë që fjala "adhurim" përdoret në Kur'an, do të thotë Teuhid". Të tilla si "Adhurimi i Allahut" do të thotë "veçimi i Tij me adhurim", **"O njerëz adhurojeni Zotin tuaj"** do të thotë "O ju njerëz veçoni Zotin tuaj me adhurim".

Së katërti, Tre Parimet Themelore

(1) Autori - Allahu e mëshiroftë - filloi duke përmendur tre parimet të cilat janë tre pyetjet që secili person do të pyetet për to në varr. Ai tërheq vëmendjen e lexuesit duke bërë një pyetje, dhe pastaj duke i dhënë përgjigjen. **(2)** Autori - Allahu e mëshiroftë - sqaroi parimin e parë që: **"Zoti dhe Ai që meriton të adhurohet është Allahu i lartësuar"**. Më pas autori përmend argumentin, i cili është: **"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e botëve"**. Zoti është Ai që duhet adhuroar.

"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Zotin e botëve".

Ky ajet përmban tre kategori të Teuhidit:

Nëse të thuhet:

Cilat janë tre parimet themelore të cilat neve na obligohet ti njohim? Thuaj: "Robi, duhet të njohë Zotin e tij, fenë e tij dhe Profetin e tij Muhamedin ﷺ" **(1)**.

Nëse të thuhet:

Kush është Zoti yt?

Thuaj: Zoti im është Allahu, Ai që më ka begatuar mua dhe të gjitha krijesat me mirësitë e Tij. Ai është i adhuruari im, unë nuk adhuroj askënd tjetër përveç Tij. Argument për këtë është: **"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve"** (Kur'ani 1:1) **(2)**.

ç'do gjë përveç Allahut është e krijuar dhe unë jam njëra prej atyre krijesave **(3)**.

"Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet ..."

pohon Teuhidin e Emrave dhe Cilësive.

"... për Allahun"

pohon Teuhidin e adhurimit.

"... Zotit..."

pohon Teuhidin e Zotërimit.

(3) Kjo do të thotë se ç'do gjë tjetër përveç Allahut është krijuar dhe përderisa unë jam i krijuar, atëherë është një domosdoshmëri për mua të falënderoj Krijuesin, Begatuesin, Mirëbërësin.

Nëse të thuhet:

Si e njohe Zotin tënd? Thuaj: "Me anë të shenjave të Tij dhe krijesave të Tij, Nga shenjat e Tij janë: nata, dita, dielli dhe hëna. Nga krijesat e Tij janë: shtatë qiejt, shtatë tokat dhe ç'farë ka në to dhe ç'farë ka midis tyre, argument për këtë është:

"Dhe nga shenjat e Tij janë nata, dita, dielli dhe hëna. Mos bëni sexhde as për diellin, as për hënën, por bëni sexhde vetëm Allahut i Cili i krijoi ato, nëse e adhuron vetëm Atë" (Kur'ani 41:37).

Gjithashtu thënia e Tij:

"Në të vërtetë Zoti juaj është Allahu që krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë, dhe pastaj u ngrit mbi fron. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përulen urdhërit të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. I madhëruar është Allahu, Zoti i botëve" (Kur'ani 7:54)

(1).

Zoti është Ai që duhet adhuruar, dëshmia është thënia e Tij:

21. O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat); 22. i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju. Prandaj mos adhuroni të tjerët krahas Allahut duke qenë se ju e dini (që nuk ka Zotërues përveç Tij).

(Kur'an 2:22) (2)

Ibn Kethiri (1300-1373) Allahu e mëshiroftë - ka thënë:

"Vetëm Ai që krijoi këto gjëra meriton të adhurohet". (3)

(1) Autori përmend disa prej shenjave universale dhe krijesa që tregojnë egzistencën e Allahut dhe pohojnë se nuk ka Zot dhe Krijues dhe të Adhuruar me të drejtë përveç Allahut.

Pastaj ai përmendi argumentet nga Kur'ani.

* Ç'do objekt i krijuar është një shenjë që dëshmon egzistencën e Allahut të madhëruar. Megjithatë, autori bëri dallim midis shenjave në univers dhe objekteve të krijuara, pasi që shenjat kalojnë nëpër ndryshime, siç është nata dhe dita. Ajo që ndryshon është një provë më e fortë se ajo që nuk ndryshon.

(2) Disa nga dijetarët kanë thënë në lidhje me këtë ajet në kapitullin e dytë të Kur'anit:

Ky ajet përmend thirrjen e parë në Kur'an "**O njerëz**", dhe aty është urdhëri i parë në Kur'an "**adhuroni**", aty është po ashtu ndalesa e parë në Kur'an: "**Prandaj mos adhuroni të tjerët krahas Allahut**" është ndalesë prej shirkut.

(3) Ai që është i veçuar në Zotërim duhet të veçohet me adhurm.

Autori përcjell fjalët e Ibn Kethirit me një numër adhurimesh të zemrës dhe trupit, duke përmendur argumentet nga Kurani dhe Suneti për secilën prej tyre.

LUTJA (Dua'ja); ndahet në:

1. Lutjen e Adhurimit:
ajo është lutja përmes gjuhës së situatës
Siç është
Namazi,
Agjërimi,
Haxhi etj...
(adhuruesi sikur lutet me realitetin e gjendjes së tij që ti dhurohet Mirësia sh.p)

2 Lutjen e kërkesës:
ajo është lutja përmes shprehjes së gjuhës;
siç është thënia: o Zot më fal, më mëshiro.

Dedikimi i saj ndokujt tjetër përveç Allahut është shirk i madh.

Rregullat e saj kërkojnë sqarime të mëtejshme siç do të vijojë.

Llojet e adhurimit që ka urdhëruar Allahu, si **Islami**, **Imani** dhe **Ihsani**, prej tyre është edhe:

Lutja (Duaja), **Frika** (Khauf), **Shpresa** (Raxha), **Mbështetja** (Teuekul), **Përmallimi** (Ragbe), **Druajtia** (Rahbe), **Nënshtimi** (khushu') **Khashje** (frikë e përzemërt me dituri), **Kthimi i zemrës kah Allahu** (inabe), **kërkimi i ndihmës, kërkimi i strehimit, ofrimi i kurbanit** (Dhebh), **të Zotuarit** (Nedhër) dhe të gjitha llojet e tjera të adhurimit që Allahu urdhëroi të gjitha këto i përkasin vetëm Allahut. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

“Vendfaljet i përkasin Allahut, prandaj, mos iu lutni askujt, krahas Allahut.” (74:18).


Pra, kush e drejton ndonjë pjesë të këtyre veprimeve të adhurimit për tjetër përveç Allahut, atëherë ai është një politeist, jobesimtar. Argument për këtë është thënia e Allahut:

"Dhe kushdo që lut (ose adhuron) në vend të Allahut ç'do ilah (zot) tjetër për të cilin nuk ka asnjë provë, atëherë llogaria e tij është vetëm te Zoti i tij. Vërtet Ai nuk do ti shpëtojë Kafirët (mohuesit e Njesisë së Allahut)"

Kur'an 23:117.

Gjithashtu Hadithi fisnik: **"Lutja është thelbi i adhurimit"**, argument për këtë është thënia e Allahut:

Lutja e kërkesës është dy llojesh:



Sa për atë që beson se personi që i është kërkuar (ndihmë), është në gjendje të sjellë dobi ose dëm, atëherë ky është Shirk.

- ❖ **Shënim:** Ne studiojmë rregullin mbi veprime të caktuara. Sa i përket rregullit mbi atë që bën këto veprime atëherë kjo ka nevojë për paraqitjen e fakteve individit dhe sqarimin e dyshimeve të tyre. Dijetarët janë ata që mund të përcaktojnë saktësisht nëse një person është një besimtar ose jobesimtar.

Njerëzit ndahen në tre lloje për sa i përket marrjes së shkaqeve

1. Disa besojnë se vetëm ajo që Allahu e ka bërë si shkak (universalisht apo fetarisht sh.p) mund të përdoret si shkak. Kjo është e sakta.

2. Të tjerët, bëjnë shkaqe ato që Allahu nuk i ka bërë si shkaqe. Ky është Shirk i vogël.

3. Grupi i tretë beson që shkaqet vetvetiu kanë efekt, sjellin dobi ose largojnë dëme. Ky është Shirk i madh.

Shkaqe fetare:

Të tilla si rukje (prej Kur'anit dhe Sunetit). Allahu e ka bërë rukjen si shkak fetar për largimin e sëmundjes.

Shkaqe universale:

Siç janë barnat; Allahu i ka bërë ato si shkak për shërimin .

Hadithi "**Duaja është thelbi i adhurimit**" është i dobët, megjithatë, hadithi autentik është "**Dua'ja është vet adhurimi**".

SI ËSHTË DUAJA VET ADHURIMI?

Ajeti: "**Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua se do t'ju përgjigjem! Me të vërtetë ata që tregohen mendjemëdhenj ndaj adhurimit Tim, do të hyjnë në xhehenem të poshtëruar!**" (Kur'an 40:60)

Shprehja "**adhurimit Tim**" tregon që lutja është vet adhurimi.

Argumenti për **frikën (1)**

(El Khauf) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

“Kështu që, mos iu frikësoni atyre, por m’u frikësoni Mua, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”

[Al Imran, 175].

Argumenti për **shpresën**

(Raxha) është Fjala e Allahut të Madhëruar:

“E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd.”

[El Kehf, 110].

(2) Shpresa: ëndja e njeriut për të arritur diçka. Shpresa që shoqërohet me përlësi dhe nënshtrim duhet të jetë vetëm për Allahun; drejtimi i saj për dikë tjetër përveç Allahut është Shirk i Madh. Shpresa e lavdërueshme është vetëm për atë që i bindet Allahut dhe shpreson për shpërblimin e asaj veprë, ose pendohet nga mëkatet dhe shpreson që ti pranohet pendimi, ndërsa shpresa pa vepra, është mashtrim dhe shpresë e nënçmuar.

(1) Frika është:

Ndjenjë që vjen si rezultat i ballafaqimit me atë që mund të dëmtojë ose shkatërrojë.

Allahu na ka ndaluar të frikësohemi nga miqtë e shejtanit dhe na ka urdhëruar të kemi frikë vetëm Atë.



Kuptimi i Teuekulit (1) (Mbështetjes)

Kuptimi gjuhësor:

Të mbështetemi në diçka ose tek dikush.

Fetarisht:

varësia e vërtetë ndaj Allahut e shoqëruar me lidhje të fortë ndaj Tij, duke mos i anashkaluar shkaqet e ligjësuara.

Tre kushtet që e bëjnë Teuekulin të vlefshëm

Vërtetësia:

Të jetë e sinqertë mbështetja ndaj Allahut

Siguria:

Ndjenja e sigurisë që Allahu e realizon premtimin e vet.

Marrja e shkaqeve të ligjshme:

(fetare apo që ju është vërtetuar dobia universalisht sh.p)

Dëshmi për Mbështetjen (Teuekul) është thënia e Allahut:

"...Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu" (Kurani 5:23).

Dhe thënia e Tij: **"...Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai"** (Kurani 65: 3) (1)

Argument për përmallimin, druajtjen dhe nënshtrimin është thënia e Allahut:

"Me të vërtetë, ata nxitonin për të bërë vepra të mira dhe Na luteshin, me përmallim dhe me druajtje dhe ishin përherë të nënshtruar ndaj Nesh" (Kurani 21: 90) (2).

(2) **Përmallimi:** nostalgjia, malli për diçka, të njohur.

Druarja: Një frikë që e çon njeriun të largohet nga ajo çfarë ka frikë, ajo është një frikë e bashkuar me vepër. Druarja në shqip është pasiguri.

Nënshtrim: Përlulja para madhësisë së Allahut duke ju dorëzuar dëshirës së Tij universale dhe fetare.

Është e domosdoshme për udhëtarin për tek Allahu i Lartësuar, që të kombinojë mes frikës dhe shpresës. Nuk është e saktë të mbështetet vetëm në njërin prej tyre e kështu të shkatërrohet. Frika dhe shpresa duhet të jenë të pranishme si krahët e një shpendi (ekuivalente sh.p).

Dëshmi për Frikë-respektin është thënia e Allahut: **“Mos u frikësoni prej tyre, por kini frikë prej Meje”**

(Kur'ani 2: 150) **(1)** Dhe dëshmia për kthimin (*inebeh*) është thënia e Allahut: **“Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij”** (Kur'an 39:54) **(2)**

Argumenti për Kërkimin e Ndhmës (*isti'aneh*) është thënia e Allahut: **“Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”** (Kurani 1: 4). Gjithashtu hadithi:

“Kur të kërkosh ndihmë, kërko ndihmë nga Allahu” (Tirmidhi). **(3)**

Dëshmi për kërkimin e strehimit është thënia e Allahut:

“Thuaj: Kërkoj strehim te Zoti i agimit” (Kur'ani 113: 1) dhe **“Thuaj: Kërkoj strehim te Zoti i njerëzve”**

(Kur'ani 114: 1) **(4)**.

Argumenti për përgjërimin (*istigathe*) është thënia e Allahut: **“(përkujtoni) kur ju kërkuat ndihmë me përgjërime nga Zoti juaj dhe Ai iu përgjigjë...”** (Kur'ani 8: 9) **(5)**

Argument për bërjen e kurbanit (Dhebh) është thënia e Allahut: **“Thuaj: “Sigurisht falja ime, kurbanim, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok e të barabartë me Të.”** (Kur'ani 6: 162-163).

Gjithashtu nga Suneti: **“Allahu mallkoi atë i cili ther kurban për dikënd tjetër përveç Tij.”** (Muslim)

(6)

(1) Frikë-respekti:

Është një frikë e bazuar në njohjen e Madhësisë së Atij që i frikësohemi, dhe Epërsisë së Tij të plotë.

(2) Kthimi tek Allahu duke iu bindur Atij dhe duke qëndruar larg mëkateve **“kthehuni tek Zoti juaj dhe dorëzohuni Atij”** do të thotë tia dorëzosh çështjen tënde Allahut, sepse ti je rob, dhe robi i dorëzohet zotërisë së tij, **“zotëria është Allahu”**, siç ka thënë i Dërguari ﷺ.

(3) Të kërkuarit ndihmë: “Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë”

Ky ajet tregon një metodë të përkufizimit (*hasr*) pasi që objekti i fjalisë, edhe pse zakonisht vjen pas foljes në gjuhën arabe, përmendet para foljes, duke e theksuar pohimin dhe nënkuptuar mohimin e ç'do gjëje tjetër në adhurim. Prandaj, është sikur të thonte : "Ne nuk adhurojmë asgjë tjetër përveç Teje. Ne nuk i drejtohem askujt tjetër për ndihmë përveç Teje."

(4) Të kërkuarit strehim: të kërkuarit strehim nga diçka e papëlqyeshme.


(5) Përgjërimi: të kërkuarit shpëtim nga një vështirësi ose katastrofë.

Kërkimi i ndihmës, kërkimi i strehimit dhe përgjërimi mund t'i kërkohej një njeriu përderisa plotësohen katër kushte: Të jetë i gjallë, i pranishëm, i aftë, dhe të merret vetëm si shkak.

(6) Bërja e Kurbanit:

Flijimi i kafshës sipas një mënyre të caktuar.

Therja e kafshëve ndahet në tre kategori



Argumenti për en-Nedhr (përmbushja e zotimit) është thënia e Allahut: **"Ata (janë të cilët) përmbushin zotimet (e tyre) dhe i frikësohen një Dite, e keqja e së cilës ka përmasa të mëdha." (1)** (Kur'an 76: 7).


- ❖ **Shënim:** Ka edhe shumë detaje të tjera në lidhje me kurbanin që përmenden në komentin e "Librit të Teuhidit"

(1)Përkufizimi i Zotimit



- ❖ **Shënim:** Zotimet janë të llojeve të ndryshme dhe kanë kushte dhe shlyerje, siç është shpjeguar në komentin e "Librit të Teuhidit".

Llojet e zotimit



- ❖ Këto adhurime që i përmendi autori, nuk janë gjithpërfshirëse, por janë për të dhënë një vështrim të përgjithshëm. Ka adhurime të tjera që nuk janë përmendur, e rëndësishme është që: kushdo që ia drejton këto adhurime dikujt tjetër përveç Allahut ka bërë shirk.

Parimi i dytë themelor: njohja e fesë islame me argumente; dhe është: Dorëzimi (nënshttrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshttrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.

Kjo përmbledh tri kategori:

1. Islami

2. Imani (Besimi)

3. Ihsani

Dhe secila nga këto kategori ka shtyllat e saj.

Kategoria e parë: Islami (1)

Shtyllat e Islamit janë pesë:

1. Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut (2), dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut.

2. Falja e namazit

3. Dhënia e zekatit

4. Agjërimi i Ramazanit

5. Bërja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Kabe).

(1) Autori fillon themelin e dytë, që është njohja e fesë, duke përkufizuar Islamin:

Shkalla e parë: Islami

Dorëzimi (nënshttrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshttrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.

Përkufizimi i islamit nënkupton dorëzimin e të gjitha çështjeve të Allahut, pasi që ne jemi robër (të Allahut) dhe rob i nënshtrohet zotërisë së tij, ndërsa zotëria është Allahu, siç jemi njoftuar për këtë nga Profeti ﷺ.

Pastaj e ndau fenë në tri nivele:



(2) Shtyllat e islamit janë pesë; e para prej tyre:

Shehadeti (dëshmia)

Autori përmendi argumentin për dëshminë La ilahe il-Allah dhe sqaroi që kuptimi i saj është: "Nuk ka të adhuruar tjetër më të drejtë përveç Allahut".

Patjetër duhet që **Dëshmia e Singjeritetit** të përfshijë:

Mohim

Pohim

Mohimi është "Nuk ka të adhuruar me të drejtë"

Pohimi është tek shprehja "përveç Allahut"

Struktura e kësaj fjalie tregon kufizim; ajo kufizon adhurimin vetëm për Allahun dhe e mohon atë për të tjerët përveç Tij.

Për këtë arsye autori tha: Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahim babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, Ai do të më drejtojë!"

Shprehja e Ibrahimit **"unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju"** është kuptimi i "Nuk ka të adhuruar me të drejtë".

"përveç Atij që më krijoi" është kuptimi i "përveç Allahut."

Argumenti për **dëshminë** është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Fuqplotit, më të Urtit."

[Al Imran, 18].

Kuptimi i të cilës është: Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.

Me **"La ilahe"** (لا إله) është për qëllim **mohimi** i ç'do gjëje që adhurohet përveç Allahut.

Ndërsa **"il Allah"** (إلا الله) është **pohimi** (me ngulm) se vetëm Allahu është Ai i Cili e meriton adhurimin me të drejtë. Ai nuk ka shok në adhurim ndaj Tij, ashtu siç Ai nuk ka shok në sundimin e Tij.

Kuptimin e së cilës na e sqaron Fjala e Allahut të Madhëruar:

"(Përkujto, o i dërguar) Kur Ibrahim babait të vet dhe popullit të tij i tha: "Unë jam i larguar prej asaj që adhuroni ju, përveç Atij që më krijoi, Ai do të më drejtojë!"

Dhe ai (Ibrahimi) e la të përjetshme atë fjalë (besimin në një Zot) ndër pasardhësit e vet, me shpresë që ata të kthehen prej rrugës së gabuar në rrugën e drejtë." [Ez Zuhruf, 26-28].

Gjithashtu, thënia e Tij: Thuaj: “O ithtarë të librit, ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, përveç Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë gjë shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin si zota përveç Allahut”! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)!”

(Al Imran, 64) (1)

❖ Nëse thuhet: Kuptimi i dëshmisë 'La ilahe ila Allah' është: Nuk ka të adhuruar përveç Allahut?

Atëherë ne themi se kjo është e pasaktë pasi me këtë ai aprovon ç'do gjë që adhurohet përveç Allahut, mirëpo nëse shton shprehjen "**me të drejtë**", kjo tregon se ai mohon ç'do gjë që adhurohet përveç Allahut dhe se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut.

❖ Nëse thuhet: Kuptimi i "La ilahe il-lAllah" është: Nuk ka Zot të vërtetë përveç Allahut, atëherë themi se kjo deklaratë është e saktë, megjithatë, nuk është kuptimi i "La ilahe il-lAllah", sepse ajo shpreh Teuhidin rububije (Njëshmërinë e Zotërimit), i cili besohej edhe nga adhuruesit e idhujve, të cilëve u ishte dërguar Profeti ﷺ, megjithatë, kjo nuk i futi ata në Islam.

(1) "**Thuaj, o ithtarët të Librit, ejani të biem në një fjalë që është e njëjtë mes nesh...**". Ky ajet është një dëshmi për përgënjeshttrimin e thirrjes për "unitetin e feve".

Argumenti i pjesës së dytë të dëshmisë: **Muhammedi është i Dërguari i Allahut**, është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vien rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." [Et Teube, 128].

Kuptimi i dëshmisë: **"Muhammedi është i Dërguari i Allahut"** është:

- bindja ndaj tij në atë që ai ka urdhëruar,
- të besuarit në atë që ai ka lajmëruar,
- të shmangurit (të larguarit) nga ajo që ai ka ndaluar
- dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe vetëm se me atë që Ai ka ligjëruar. **(1)**

(1) Autori e sqaroi kuptimin e dëshmisë që **Muhamedi është i Dërguar i Allahut** ﷺ dhe që është e obliguar për ç'do musliman që ta realizojë këtë dëshmi.

Kuptimi i dëshmisë që "Muhammedi është rob dhe i dërguar i Allahut":

Ai është rob që nuk adhurohet dhe i dërguar që nuk përgënjeshtrohet, kjo do të thotë që:

Ne duhet t'i bindemi atij në atë që ai ka urdhëruar pasiqë:

ai vetëm e ka përcjellë atë prej Allahut.

T'i besojmë asaj që ai na ka informuar pasiqë:

Ai është që e ka thënë të vërtetën dhe i është thënë e vërteta.

T'i qëndrojmë larg ndalesave të tij:

Duke i vendosur ato me një skajë, kurse ne të qëndrojmë me një skajë tjetër.

Të mos e adhurojmë Allahun vetëm se me atë që ka ardhur Profeti ﷺ: Kjo është një provë kundër risimtarëve në fenë e Allahut.

Argumeti për **namazin (1)**, dhënien e **zekatit (2)** dhe shpjegimin i **teuhidit** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"Dhe ata nuk u urdhëruan për tjetër, përveç asaj që të adhuronin vetëm Allahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç ose përkrah Tij, të kryenin faljen e detyruar të namazit e të jepnin zekatin: dhe kjo është feja e drejtë, e vërtetë."** [El Bejjine, 5].

Argumenti i **agjërimit të Ramazanit (3)** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."** [El Bekare, 183].

Argumenti për **bërjen e Haxhit (4)** është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"Për hir të Allahut, Haxhi është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit."**
Kuran 2:97

(1) Shtylla e dytë: Namazi.

Namazi është adhurimi i Allahut me fjalë dhe vepra të caktuara, duke filluar me 'Tekbir' ('Allahu Ekber' - 'Allahu është më i Madhi') dhe duke përfunduar me 'Teslim' (përsëndetjen e paqes), ajo është shtylla e fesë. Është bërë obligim direkt nga Allahu ndaj Profetit ﷺ atëherë kur ai u ngrit në qiell (natën e miraxhit).

(2) Shtylla e tretë: Bamirësia e detyrueshme (Zekati).

Në kuptimin gjuhësor do të thotë zhvillim dhe pastrim. Ajo është e dy llojeve: Pastrimi i trupit dhe pastrimi i pasurisë.

(3) Shtylla e katërt: Agjërimi.

Përkufizimi gjuhësor: Të përmbahesh (ndaj diçkaje).

Përkufizimi fetar: Adhurimi i Allahut duke u përmbajtur nga ajo që prish agjërimin me një qëllim të singertë, nga agimi deri në perëndim të diellit. Është nga adhurimet më të mira pasi që të tre llojet e durimit janë të pranishme në të, gjithashtu, ajo që tregon statusin e tij të madh është fakti se Allahu ia ka përkatësuar Vetes së Tij shpërblimin e agjëruesit.

(4) Shtylla e pestë: Haxhi

Përkufizimi gjuhësor: Është synimi

Përkufizimi fetar: Të adhurosh Allahun duke kryer ritet e haxhit sipas mënyrës Profetike. Është obligim për ç'do musliman një herë në jetë.

Shkalla e dytë: Imani

Gjuhësisht:

Pranimi

Fetarisht:

Fjalë me gjuhë, bindje me zemër dhe vepër me gjymtyrë, shtohet me vepra të mira dhe mangësohet me vepra të këqija.

Imani në legjislacionin islam është i përbërë nga pesë kushte; nëse mungon njëra nga këto pesë gjëra, atëherë del prej përkufizimit të Ehli Sunnetit që ja bëjnë besimit.

Çfare është dëshmi për këto pesë kushte?

Hadithi:

“Më e larta e saj (besimit) është fjala **La ilahe il la Allah**”

kjo është dëshmi për fjalët,

“dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga”

Kjo është vepër e gjymtyrëve,

“Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit”

Kjo është vepër e zemrës.

Besimi ndahet në shtatëdhjetë e disa degë, ku më e larta e saj është fjala **La ilahe il la Allah**, dhe më e ulta e saj është heqja e pengesës nga rruga. Edhe turpi është prej degëve (pjesëve) të besimit.

Shtyllat e besimit janë gjashtë:

1. Të besosh në Allahun e Madhëruar.
2. Të besosh në engjëjt e Tij
3. Të besosh në librat e Tij
4. Të besosh në të dërguarit e Tij
5. Të besosh në ditën e Fundit
6. Të besosh në përcaktimin e Allahut për mirë dhe për keq.

Argumenti për pesë shtyllat e para të besimit është Fjala e Allahut të Madhëruar: **"Nuk është tërë e mira (e kufizuar) t'i ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson Allahut, ditës së fundit, engjëjve, librit, pejgamberëve."** [El Bekare, 177].

Ndërsa argumenti për **përcaktimin e Allahut** është Fjala e Tij:

"Ne ç'do gjë e kemi krijuar me përcaktim preciz."

[El Kamer, 49].

Dhe thënia e Allahut: **"Cilit prej jush ia ka shtuar kjo (sure) besimin?"** (Kur'ani 9: 124) dëshmon se besimi shtohet, përderisa shtohet atëherë patjetër që edhe ulet. Është përmendur qartë nga Profeti ﷺ në thënien e tij: **"Nuk kam parë më të mangëta në logjikë dhe në fe..."**, pra feja (besimi) pakësohet.

Gjashtë shtyllat e imanit:



Shtylla e parë: Besimi tek Allahu



Shtylla e dytë: Besimi në engjëj

Engjëjt janë nga bota e fshehtë. Allahu i krijoi ata nga drita. Ata i binden Allahut dhe kurrë nuk e kundërshtojnë Atë. Ata kanë shpirtra: **"e zbriti atë shpirti i shenjtë"**(2:87), kanë trupa **"Ai i cili i ka bërë engjëjt të dërguarit me krahë"** (35: 1), kanë zemra dhe logjikë **"Kur t'u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë: "Çfarë tha Zoti juaj?"** (34: 23). Ne besojmë në ta, dhe në atë që Allahu na ka informuar prej emrave të tyre (Xhibril, Mikail, Israfil, etj.), cilësive të tyre (p.sh: Nuk e kundërshtojnë Allahun në atë që I urdhëron), veprat e tyre (p.sh: mbajtësit e Fronit të Allahut) dhe gjithçka që jemi informuar për ta.

Shtylla e tretë: Besimi në Libra

Besojmë që ato janë nga Fjalët e Allahut, janë zbritur tek ne e nuk janë të krijuar. Allahu dërgoi me ç' do të Dërguar një libër. Ne besojmë në to dhe në atë që Allahu na ka njoftuar prej emrave të tyre, lajmet që përmbajnë ato dhe dispozitat e tyre të cilat nuk janë shfuqizuara nga Kurani, meqë Kur'ani ka shfuqizuar ato libra që kanë qenë para tij nga këto Shkrime, siç janë: Fletushkat e Ibrahimit, Teurati, Zeburi, Inxhili.

E katërta: Besimi në të dërguarit

Ne besojmë se ata janë si të gjithë njerëzit dhe se nuk posedojnë asnjë nga karakteristikat e Zotërimit dhe se ata janë robër të Allahut që nuk adhurohen; Allahu i dërgoi ata , i frymëzoi dhe i ndihmoi me shenjat e Tij. Ata përcjellin atë që u është besuar atyre, këshilluan popujt e tyre, e përmbushën misionin e tyre dhe janë përpjekur në rrugën e Allahut me një përpjekje të vërtetë. Ne besojmë në të gjithë ata, emrat e tyre, cilësitë e tyre, historitë e tyre. I pari i Profetëve është Ademi, i Dërguari i parë është Nuhu dhe vula e Profetëve është Muhamedi ﷺ. Të gjitha ligjet e mëparshme u shfuqizuan nga ligji i shpallur i Muhamedit ﷺ. Pesë më të zgjedhurit e tyre janë:

Muhamedi ﷺ, Nuhu ﷺ, Ibrahimit ﷺ, Musa ﷺ, Isa ﷺ.

E pesta: Besimi në Ditën e Fundit

Besimi në Ditën e Fundit përmban besimin në ç'do gjë që do të ndodh pas vdekjes, siç është: Sprova e Varrit, Fryerja e Surit (për shkatërrim të universit dhe për ringjallje), ngritja e njerëzve nga varrezat e tyre, Mizani (Peshorja e Drejtësisë), shpërndarja e Fletushkave të veprave, Sirati (rruga e vendosur mbi Zjarrin), Haudi (Kroi i Profetit ﷺ), Ndërmjetsimi Profetik për ata që nuk kanë bërë shirk, Kopshtet e Përjetësisë (Xhenneti), Zjarri, shikimi i besimtarëve në Zotin e tyre në Xhennet dhe gjërat e tjera të fshehta për të cilat na kanë informuar të Dërguarit e Zotit.

E gjashta: Besimi në Kader:

(konsiston në katër çështje)



Shkalla e tretë: Ihsani

**Është niveli më i lartë i fesë,
ka një shtyllë nën të cilën janë
dy degë:**

Adhurimi i Mushehededes (sikur e sheh Atë) nga dashuria, ëndja dhe malli për atë që është tek Allahu.* Shembull për këtë është: adhurimi i të Dërguarve dhe i Lajmëtarëve. Është e mundur edhe për të tjerët që të arrijnë këtë shkallë.

Adhurimi i Murakabes (adhurim duke e pas parasysh mbikëqyrjen e Allahut). Ai është adhurim frike dhe ikje nga dënimi. Një musliman nuk del jashtë këtij rrethi.

Kategoria e tretë: Ihsani.

Ka vetëm një shtyllë dhe ajo është: Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të sheh ty.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Lartësuar:

"S'ka dyshim se All-llahu është me ata që janë të devotshëm dhe me ata që janë bamirës."

[El Nahl. 128].

"Dhe mbështetu në të Plotfuqishmin, Mëshiruesin e madh, i Cili të sheh kur të ngrihesh në këmbë, (e të sheh) edhe lëvizjen tënde në mesin e atyre që falen. Në të vërtetë, Ai është Dëgjuesi i ç'do gjëje, i Gjithëdijsmi."

[Esh Shuara, 217-220]

"As ti (o Muhammed) nuk bën ndonjë vepër, as nuk lexon ndonjë pjesë nga Kurani, dhe as ju nuk bëni ndonjë vepër, veçse Ne jemi Dëshmues mbi ju kur ju e kryeni atë." [Junus, 61].

***Sqarim:** Kjo nuk do të thotë se ai që adhuron Allahun në këtë mënyrë e bën këtë vetëm nga dashuria dhe nuk i frikësohet Atij, mirëpo në këtë nivel, shtytësi më i fortë që e shtyn robin për adhurim është dashuria e Allahut të Lartësuar.

Profeti ﷺ tha: **"A të mos jem një rob falënderues?"** (Muslimi).

Argumenti nga suneti.

Hadithi i njohur i Xhibrilit i transmetuar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i cili ka thënë: Një ditë ishim duke qëndruar me të Dërguarin e Allahut ﷺ, kur na u shfaq një burrë me rroba shumë të bardha dhe me flokë shumë të zeza. Nuk dukeshin tek ai gjurmët e udhëtimit dhe askush nga ne nuk e njihte atë. U ul pranë Profetit ﷺ dhe mbështeti gjunjët e tij tek gjunjët e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe vendosi duart te kofshët e tij dhe tha:

"O Muhammed, më trego ç'është Islami?"

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

"Islami është të dëshmuarit se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh muajin e Ramazanit dhe të kryesh haxhin nëse ke mundësi."

Tha: "Të vërtetën ke thënë."

(Umeri thotë) U habitëm me të, edhe pyet edhe vërteton!

Tha: "Më trego ç'është Besimi (Imani)?"

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

"Të besosh në Allahun e Madhëruar, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit, si dhe të besosh në përcaktimin e Allahut për mirë dhe për keq."

Tha: "Të vërtetën ke thënë."

Tha: "Më trego për ihsanin."

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

"Ta adhurosh Allahun e Madhëruar sikur je duke e parë, se edhe pse ti nuk e shikon Atë, Ai me të vërtetë të shikon ty."

Tha: "Më trego për Kiametin."

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

"I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi".

Tha: "Më trego për shenjat e tij."

I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

"Kur të lindë robëresha zonjën e saj, kur të shihen barinj të këmbëzbathur, të zhveshur e të mjerë se si garojnë në ndërtimin e ndërtesave të mëdha."

Tha (Umeri): Ai u largua ndërsa ne mbetëm të habitur.

I Dërguari ﷺ më tha:

"O Umer, a e di se kush ishte pyetësi?"

Thashë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri!

Tha: "Ai ishte Xhibrili, erdhi që t'ua mësojë fenë tuaj."

Transmeton Muslimi

Ky hadith është dëshmi për shtyllat e islamit, imanit dhe ihsanit. Thënia e Profetit ﷺ "I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi" është një dëshmi që askush nuk e di kur Dita e Gjykimit do të jetë përveç Allahut.

Thënia e tij:
robëresha do të lindë
zonjën e saj do të
thotë:

Mosrespekti ndaj
prindërve do të rritet

Robëria do të rritet

Mbraptësia e gjendjes
(në shoqëri)

Mbreti do të
martohet me një
robëreshë e cila do ti
lind djalin e tij, pasi
mbreti të vdes biri i
tij bëhet mbret, po
ashtu padron i nënës
së tij.

Dobitë e hadithit të Xhibrilit

1. Janë gjashtë të drejta që duhet ti përmbush nxënësi: **e drejta ndaj vetes, e mësuesit, e vendit** ku ai mëson, **e kolegëve të tij, e librit** dhe **e drejta diturisë** që e ka mësuar.

E drejta ndaj vetes: Meqë dituria është adhurim, singëriteti dhe ndjekja e Sunetit janë një domosdoshmëri. Bëhu një ndjekës i të parëve të mirë, druaju Allahut me një frikë të vërtetë në bazë të diturisë, kij parasysht mbikqyrjen e Allahut, bëhu modest dhe largoju mendjemadhësisë.

Të jesh i kënaqur me atë që ke, bëhu asket (larg gjërave që nuk të bëjnë dobi në botën e përtejme). Zbukuroje veten me efektet e diturisë, sjelljet e mira që janë të pranueshme për popullin, të kesh karakteristika burrërore, largoju arrogancës dhe të ndjerit më superior ndaj kolegëve tu dhe të tjerëve. Qëndro larg nga mbledhjet dhe takimet e kota, zbukuro veten me butësi, ji i patundur në të vërtetën, vërtetoi lajmet.

Të kesh ambicie të larta, dëshirë të fortë për të kërkuar dituri, udhëto për diturinë, ruaje njohurinë me anë të shkrimit, memorizimit, të punuarit me të dhe përsëritjes. Drejtohu Allahut për ndihmë, respekto besnikërinë shkencore dhe ji i singertë.

Mburoja e nxënësit të diturisë është thënia 'nuk e di', ruaje kohën, kërko njohuri të përgjithshme për tema të ndryshme, lexo me kujdes dhe saktë, lexo po ashtu edhe librat voluminozë.

Bë pyetje të përshtatshme, dëgjo me kujdes, kupto mirë dhe pastaj vepro me të, debato pa konflikt për hir të gjetjes dhe pranimi të së vërtetës, rifreskoni njohuritë me përsëritje. Qëndro midis Kur'anit, Sunetit dhe shkencave të tyre. Studioni temat e rëndësishme të ç' do shkence.

Veproni me njohuritë, largoju pasionit për udhëheqje, famë dhe stolitë e kësaj bote.

Mendo keq për veten tënde, ndërsa për të tjerët mendo mirë.

Jepe zekatin e diturisë duke: urdhëruar për të mirën, ndaluar të keqen, duke përhapur diturinë, duke dashur që të tjerët të përfitojnë, duke përdorur statusin / pozitën tënde për të ndërmjetësuar për muslimanët me ndërmjetësime të mira; për të përfaqësuar të vërtetën dhe gjithçka që është e mirë.

Të jesh fisnik, ruaje diturinë, sillu mirë me njerëzit duke mos i shkelur parimet e tua fetare, qëndro larg vëndeve me pozitë para se të jesh i kualifikuar për këtë.

Mbaj qëndrim të përshtatshëm në lidhje me gabimin e një dijetari apo me dallimet në mendime që gjenden midis dijetarëve. (Sh.p: gabimi refuzohet kur bëhet e qartë, megjithatë, virtyti i dijetarit ngelet, dhe ai respektohet dhe nuk flitet keq për të).

Largoju dyshimeve, mos bë partishmëri me ndonjë grup të caktuar përmes së cilit do ti miqësosh të tjerët apo armiqtësosh.

E drejta e mësuesit: Njerëzit janë tre kategori lidhur me këtë; dy ekstreme dhe një mesatar. Ne do të mësojmë – me lejen e Allahut - se shirku i parë që ndodhi në tokë është për shkak të egzagjerimit të statusit të njerëzve të mirë, prandaj është e domosdoshme që ne të mbetemi mesatar me të mirët; duke mos e tepruar duke u dhënë atyre të drejta që ata nuk i meritojnë dhe as duke neglizhuar të drejtat që u takojnë atyre.

E drejta e vendit ku studion.

E drejta e kolegëve të tij:

Allahu i Lartësuar ka thënë: "**Ju ishit Ummeti (Populli) më i mirë që ka dal për njerëzit**" dhe Profeti ﷺ ka thënë:

"Asnjëri prej jush nuk beson derisa të dojë për vëllanë e tij atë që e do për vete".

E drejta e librit: Ruajtja e librit dhe kujdesja për të. Këto libra janë një begati nga Allahu, kështu që na takon që t'i ruajmë ato.

E drejta e diturisë: Përpikmëria në dituri, ripërsëritja e saj, të vepruarit me të, kjo sepse është obligim për atë që mëson që të punojë sipas asaj diturie të mirëfilltë, pastaj ti thërras të tjerët në të, pasi kjo është një mirësi që duhet falënderuar.

2. Nga edukatat e pyetjes është që të bëhet ajo pyetje përmes së cilës shpresohet që të arrihet dobja.

3. Nxënësi i diturisë duhet të kujdeset për pamjen e tij.

4. Pas vdekjes së Profetit ﷺ nuk thuhet: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri", mirëpo thuhet vetëm: "Allahu e din më së miri".

Parimi i tretë:**Njohja e Profetit tuaj,****Muhammedit ﷺ**

Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (shumë të afërtit të Allahut). Mbi të dhe mbi të Dërguarin tonë qofshin salavatet dhe selamet më të mira. Ai ﷺ ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare, ku prej tyre 40 vjeç i kaloi para se të bëhej i Dërguar dhe 23 prej tyre i kaloi duke qenë Profet dhe i Dërguar. U bë Profet (Nebij) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: **"Lexo!"** dhe u bë i Dërguar (Resul) me Fjalën e Allahut të Madhëruar: **"O ti i mbuluar!"**. Vendlindja e tij është Meka

Ky paragraf përfshinë një përshkrim të Profetit ﷺ, i cili përmban: emrin e tij, prejardhjen e tij, moshën e tij, një pjesë të thirrjes së tij.

Çfarë duhet te dimë rreth Profetit ﷺ

Emri dhe prejardhja e tij:

Ai është: Muhammed bin Abdullah bin Abdul Mutalib bin Hashimi, ndërsa Hashimi është prej kurejshve, e kurejshët janë prej arabëve. Arabët janë prej pasardhësve të Ismail bin Ibrahim el Khalil (shumë të

Mosha e tij:

Mosha e tij: 63 vjeç, prej tyre 40 vjet para profetësisë dhe 23 vjet si i Dërguar dhe Profet.

Profetësia e Tij ndahet në dy periudha:

Periudha Mekase

ajo zgjati 13 vjet.

Periudha Medinase

Ajo zgjati 10 vjet

A është ai ﷺ Profet apo i Dërguar?

Ai u bë profet me ajetin **"Ikra"** dhe më pas është bërë i Dërguar me fillimin e kaptinës **"el-Mudetthir"**.

Një përmbledhje e shkurtër e biografisë së tij

Thirrja e tij gjatë periudhës Mekase ishte e përqendruar te Teuhidi dhe braktisja e Shirkut dhe që të jetë adhurimi i singjertë vetëm për Allahun. Kjo thirrje vazhdoi në këtë mënyrë për një periudhë prej 13 vitesh.

Pastaj ai ﷺ u urdhërua që të shpërngulet në Medinë, po ashtu thirrja e tij vazhdoi kryesisht duke u përqendruar tek Teuhidi, duke shtuar zbritjen e aspekteve të tjera të fesë, siç janë veprat e adhurimit, transaksionet e biznesit dhe punët e përgjithshme të jetës së përditshme.

Nëse dikush do të egzaminonte biografinë e tij do të vërente se fokusi i tij kryesor që nga fillimi i profetësisë deri në vdekjen e tij ishte Teuhidi. Në këtë ka refuzim të qartë ndaj atyre që dekurajojnë njerëzit nga mësimi i Teuhidit dhe pohojnë që mjaftojnë disa minuta për ta mësuar atë.

Allahu i Madhëruar e dërgoi për të tërhequr vërejtjen nga shirku dhe të thërrasë në Teuhid. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"O ti i mbështjellur! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe rrobat e tua pastro! Dhe larg nga Er Ruxhz qëndro! Dhe mos jep për të marrë më shumë! Dhe për hir të Zotit tënd, duro!" [El Mudethir, 1-7].

Kuptimi i **"Ngrihu dhe këshillo!"** Është që të tërheqë vërejtjen (të ndalojë) prej shirkut dhe të ftojë për në teuhid (njësimin e Allahut).

"Dhe madhëroje Zotin tënd!"
d.t.th. Madhëroje Atë me teuhid (duke e njësuar në të gjitha adhurimet).

"Dhe rrobat e tua pastro!"
d.t.th. pastroi punët e tua prej shirkut.

"Dhe larg nga Er Ruxhzu qëndro!" Er Ruxhz: Idhujt.

Me qëndrim larg prej tyre është për qëllim braktisja e idhujve dhe idhujtarëve. I Dërguari i Allahut ﷺ kaloi plot dhjetë vjet duke ftuar në teuhid, dhe mbas kësaj u ngrit në qiell dhe u urdhërua me pesë namazet. Mbas kësaj u fal në Meke tre vjet e më pas u urdhërua (nga Allahu) që të bëj hixhret për në Medine.

Nga thënia e tij "më pas u ngrit në qiell" mund të përfitojmë:

1- Ç'farëdo që ne jemi të informuar nga Profeti ﷺ nga çështjet e fshehta, ne themi lidhur me të: Ne besojmë, pohojmë se ajo është e vërteta dhe e pranojmë atë.

2- Rëndësia e faljes së namazit, duke marrë parasysh faktin se u bë e detyrueshme në qiej.

Hixhreti.

Me hixhretin është për qëllim:

"Shpërngulja prej vendit të shirkut për në vendin e islamit." Është detyrë mbi këtë popull (umet) që të bëjë hixhret prej vendit të shirkut për në vendin e islamit. E kjo do të mbesë deri sa të bëhet Kijameti. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Sigurisht për ata të cilët melekët i marrin në vdekje ndërkohë që po i bënin padrejtësi vetvetes së tyre duke qëndruar me jobesimtarët, në një kohë kur shpërngulja ishte e detyrueshme për ta, ata u thonë: "Në çfarë gjendje ishit?" Ata përgjigjen: "Ne ishim të dobët dhe të shtypur në tokë." Melekët u thonë: "A nuk ishte toka e Allahut e gjerë dhe e mjaftueshme për ju për t'u shpërngulur në të?" Njerëz të tillë do ta gjejnë vendbanimin e tyre në xhehenem. Sa përfundim i keq!" Përveç të dobëtëve, burra, gra dhe fëmijë, të cilët nuk mund të mendojnë ndonjë rrugëdalje dhe nuk janë në gjendje të drejtohen në rrugën e tyre. Për këta ka shpresë se Allahu do t'i falë. Dhe Allahu është kurdoherë Falës, gjithnjë Falës i Madh." [El Nisa, 97-99].

Gjithashtu Fjala e Allahut:

"O robërit e Mi që më besoni! Vërtet që toka Ime është e gjerë. Pra, më adhuroni vetëm Mua." [El Ankebut, 56].

El Begaviju (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është për muslimanët të cilët nuk u larguan prej Mekës (nuk bënë hixhret). Allahu i Madhëruar i thirri ata në emër të besimit".

Argumenti për hixhretin nga suneti është fjala e të Dërguarit të Allahut ﷺ:

"Nuk ndërpritet hixhreti derisa të ndërpritet pendimi, dhe nuk ndërpritet pendimi derisa të lindë dielli nga përendimi."

Hixhreti ndahet në tre kategori:

Shpërngulja nga vendi i Shirkut për në vendin e Islamit

Dispozita e saj:
obligim

Shpërngulja nga Meka në Medinë.

Kjo përfundoi pasi që Meka u çlirua.

Shpërngulja nga ç'do gjë që Allahu ka urdhëruar që të braktiset

Qoftë ajo vepër, veprues, kohë apo vend.

Vepër: ç'do gjë që Allahu e ndaloi, me në krye Shirkun.

Veprues: jobesimtarët, hipokritët dhe të ngjashmit me ta.

Kohët: Braktisja e kohëve në të cilat mosbesimtarët bëjnë festat e tyre.

Vendet: Shpërngulja nga vende të veçanta ku jobesimtarët festojnë.

Do të ndërpritet pranimi i pendimit me një nga dy mënyrat:

1- Lindja e diellit nga përendimi.

2- Vdekja

"Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të keqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: "Unë tani me të vërtetë po pendohe". As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm." 4:18

"Nuk ka hixhret pas çlirimit" i referohet hixhretit nga Meka në Medinë, ku gjithashtu ka sinjalizim që Meka nuk do të kthehet më në vend të Mosbesimit.

(1) Shejh ibn Uttejmini përmend: "Zekati u bë i detyrueshëm për herë të parë në Mekë, por Nisabi (sasia e pasurisë, plotësimi i së cilës e bën të obligueshme nxjerrjen e zekatit) dhe se sa duhet dhënë nga zekati pasiqë të bëhet obligim nuk janë përcaktuar përveç se në Medinë.

(2) Profeti ﷺ vdiq në vitin e 11 sipas hixhretit dhe u varros në shtëpinë e 'Aishes - Allahu qoftë i kënaqur me të.

(3) " Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj "; është thelbësore që ne të dëshmojmë që Profeti ﷺ e ka përmbushur amanetin e tij, ka përcjellë Mesazhin, ka këshilluar Umetin është përpjekur vërtetë për hir të Allahut derisa na la në një rrugë të qartë, nata e së cilës është e qartë sikur dita e saj, dhe askush nuk devijon prej saj përveç dështuesit.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ u vendos në Medinë u urdhërua (nga Allahu i Madhëruar) me plotësimin e sheriatit islam, siç është: zekati (1), agjërimi, haxhi, xhahadi, ezani, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, si dhe me dispozitat e tjera të fesë islame. Kjo periudhë zgjati dhjetë vjet, e pas kësaj ai ndërroi jetë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin mbi të, ndërsa feja e tij mbeti përgjithmonë. (2)

Kjo pra, është feja e tij! Nuk ka mirësi veçse ai e udhëzoi umetin për tek ajo, dhe nuk ka ndonjë të keqe veçse ai i ndaloi prej saj.

Mirësia të cilën ai ﷺ ia tregoi popullit (umetit) është teuhidi dhe ç'do gjë që Allahu i Madhëruar e do dhe është i kënaqur me të, ndërsa e keqja prej së cilës ai ﷺ ndaloi është shirku dhe ç'do gjë që Allahu i Madhëruar e urren dhe e refuzon.

(3)

Ndalesat më të mëdha

Shirku i madh:

Nxjerr prej Islamit.

Shirku i vogël:

Nuk nxjerr prej Islamt.

Mëkatet e medhaja:

ç'do veprim që i nënshtrohet një dënimi të veçantë.

Mëkatet e vogla:

ç'do veprim i ndaluar që nuk i nënshtrohet një dënimi të veçantë.

Allahu i Madhëruar e dërgoi atë ﷺ për mbarë njerëzimin dhe e bëri obligim bindjen ndaj tij për xhindët dhe njerëzit. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Thuaj: "O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguar i Allahut." [El Araf, 158].

(1)

Allahu i Madhëruar e plotësoi me të fenë. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin fe." [El Maide, 3]. (2)

Argument për vdekjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Sigurisht që ti do të vdesësh dhe padyshim që edhe ata do të vdesin, pastaj ditën e Ringjalljes, para Zotit tuaj do të zihen me fjalë njëri me tjetrin."

[Ez

Zumer, 30-31].

(1) Profeti ﷺ u dërgua për gjithë njerëzimin. Për shkak të kësaj, të gjitha legjislacionet e tjera që erdhën para tij u shfuqizuan. Hebrejtë dhe të krishterët në kohën e Profetit ﷺ dhe në kohën tonë, nëse mesazhi i islamit i arrin ata dhe nuk e pranojnë atë, konsiderohen mosbesimtarë, edhe nëse ata janë në të njëjtën fe të Musës ﷺ dhe të Isës ﷺ, argument për këtë është:

1- Thënia e Tij:

"Thuaj: "O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!"

(Kur'an 3: 64).

2- Thënia e Tij:

"Luftojini ata që nuk besojnë në Allahun e as në Ditën e Fundit, që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe ata, midis atyre që u është dhënë Libri, që nuk e pranojnë fenë e vërtetë, derisa të japin xhizjen (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përrulur. " (Kur'an 9:29).

3- Thënja e Profetit ﷺ:

" Betohe me Ai, në Dorë e të Të cilit është shpirti im, nuk ka një hebre apo të krishter që dëgjon për mua dhe pastaj vdes dhe nuk beson në atë me të cilën jam dërguar, përveç se do të jetë nga banorët e Zjarrit.

(Transmeton Muslimi).

(2) Ky ajet është një provë kundër atyre që shpikin në fe.

1- I gjithë njerëzimi do ta shijojë vdekjen pa përjashtim, dhe do të ringjallen me një ditë të madhe, ajo është Dita e Gjykimit, dhe prej aty do të gjykojnë, dhe pastaj ose do të shpërblehen ose do të ndëshkohen për veprimet e tyre.

2- Dhe kushdo që mohon ringjalljen dhe gjykimin, nuk ka besuar, sepse ai ka mohuar një shtyllë nga shtyllat e besimit.

3- Nuhu është i Dërguari i parë, argument është thënia e Tij: **"Ne të kemi shpallur ty, ashtu siç i shpallëm Nuhut dhe profetëve pas tij".**

Profeti i parë është Ademi ﷺ
Profeti ﷺ u pyet nëse Ademi ishte një profet? Ai tha:

"Një profet që i foli Allahu"
(Ibn Hiban).

Profeti dhe i Dërguari i fundit është Muhamedi ﷺ. Prova është thënia e Allahut: **"Muhamedi nuk është babai i asnjërit prej njerëzve tuaj, por ai është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve, dhe gjithsesi Allahu është i Gjithëdijshtëm për ç'gjë"** (Kur'an 33:40)

Pra, kushdo që pretendon të jetë profet ose i dërguar pas profetit Muhamed ﷺ, atëherë ai është gënjeshhtar dhe jobesimtar, dhe kushdo që i beson atij që pretendon të jetë profet, edhe ai është jobesimtar sikur pretenduesi.

Të gjithë njerëzit do të vdesin e më pas do të ringjallen. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Prej asaj (tokës) Ne iu krijuam ju, e do t'ju kthejmë përsëri në të, e prej saj do t'ju nxjerrim edhe një herë."
[Ta Ha, 55].

Gjithashtu Fjala e Tij:

"Dhe Allahu ju ka nxjerrë prej (dheut të) tokës. Pastaj Ai do t'ju kthejë në të dhe do t'ju nxjerrë përsëri prej saj." [Nuh, 17-18].

Dhe pas ringjalljes njerëzit do të llogariten dhe do të shpërblehen për punët e tyre. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Për t'i shpërblyer ata që bënë keq me të keqen e tyre dhe për t'i shpërblyer ata që bënë mirë me të mirën e tyre." [En Nexhm, 31] **(1)**

Kush e përgenjështon (mohon) ringjalljen ai ka bërë kufër. Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Ata që nuk besuan, mendojnë se kurrë nuk do të ringjallen. Thuaju: Po! Për Zotin tim! Ju padyshim që do të ringjallen, pastaj ju do të njoftoheni për çfarë punuat dhe kjo është mjaft e lehtë për Allahun."
[Et Tegabun, 7]. **(2)**

Allahu i Madhëruar i dërgoi të gjithë të dërguarit si përgëzues dhe qortues. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Të Dërguar si përgëzues dhe si paralajmërues ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut." [En Nisa, 165].

I pari prej tyre (të dërguarve) është Nuhu ﷺ dhe i fundi është Muhammedi ﷺ. Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Ne të kemi shpallur ty sikurse i patëm shpallur Nuhut dhe lajmëtarëve pas tij."
[En Nisa, 163]. **(3)**

Allahu i Madhëruar e ka bërë detyrë për të gjithë robërit e Tij që ta mohojnë tagutin dhe t'i besojnë Atij. Ibën el Kajim (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Taguti është ç' do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë, duke e pasuar apo duke iu bindur."

Tagutët janë shumë e më kryesorët janë pesë:

1. Ibli si, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!
2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim.
3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.
4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
5. Kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu.

Argument është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Nuk ka detyrim në fe. Vërtet, Rruga e drejtë është bërë e qartë nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon tagutin dhe beson në Allahun, atëherë ai është kapur për mbajtësin më të sigurt që nuk thyhet kurrë."

[El Bekare, 256].

Ky pra, është edhe kuptimi i fjalës **"La ilahe il lAllah"**

Argument nga hadithi:

"Kreu i ç' do çështjeje është Islami, shtylla e tij është namazi ndërsa kulmi i tij është xhihadi (përpyekja) në rrugën e Allahut."

Allahu i dërgoi Profetët dhe të Dërguarit si përgëzues dhe paralajmërues; të gjithë duke thirrur në Teuhid dhe duke luftuar kundër Shirkut dhe hyjnive të rreme në të gjitha format e tij.

Argument është thënia e Tij: **"Ne i dërguam secilit popull një të dërguar,(që u thoshte):" Adhurojeni Allahun , dhe shmangnjuni Tagutit"**

(Kurani 16:36)

që do të thotë t'i vendosni këto hyjnitë e rreme në njërën anë dhe te vendoseni në anën e kundërt. Kjo është mënyra më e mirë për të qëndruar larg tyre dhe për të liruar veten nga shirku dhe pasuesit e tij.

Allahu e ka bërë të detyrueshme për të gjithë adhuruesit e Tij që të mohojnë hyjnitë e rreme dhe të kenë besim tek Allahu, pra së pari duhet mohuar hyjnit e rreme para besimit në Allahun **"... Pra, kushdo që mohon Tagutin dhe beson në Allahun..."** (Kur'ani 2: 256).

Taguti është: *ç' do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë (siç janë gurët dhe drurët), duke e pasuar atë (siç janë dijetarët e këqinjë) apo duke iu bindur (bindja e prijësve në mëkate)*

Tagutat janë të shumtë por kokat e tyre janë pesë.

1. Ibli si, mallkimi i Allahut qoftë mbi të!
2. Kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim.
3. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes.
4. Kush pretendon se di diçka nga e fshehta.
5. Kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu.

Mosgjykimi me ligj të Allahut ka shtjellim

Kufr i madh:

Nëse beson që ligjet njerëzore janë sikur ligjet e Allahut, apo edhe më të mira.

Kufr i vogël:

Nëse beson se gjykimi me ligje të tjera përveç ligjit të Allahut është i kotë, por ai gjykon me to për shkak të dëshirave të tij, dashurisë për udhëheqje ose për arsye të tjera të ngjashme.

Ibn Kajimi e ka ndarë Xhihadin (përpjekjen) në katër kategori

Xhihadi ndaj Nefsit (Vetes):

Bëhet me dituri, me vepër, me thirrje në rrugë të Allahut dhe me durim.

Xhihadi ndaj Shejtanit:

Bëhet duke i lënë dyshimet (mosbesimin, risitë) dhe duke i lënë epshet (mëkatet e mëdha dhe të vogla).

Xhihadi ndaj jobesimtarëve dhe hipokritëve:

Bëhet me zemër, me gjuhë, me pasuri dhe vetveten.

Xhihadi ndaj të padrejtëve, ndaj bidatçive (risimtarëve) dhe ndaj të keqes:

Bëhet me dorë, gjuhë dhe me zemër.

Përmbyllja

Është e domosdoshme për ç' do njeri të mençur që të meditojë këtë tekst të këtij libërthi dhe ti kushtojë një kujdes të veçantë, si shkak i asaj që përmban prej parimeve madhështore të cilat njeriut i nevojiten kur të futet në varr.

Është njohja e Allahut, Profetit të Tij dhe fesë Islame me argumente. (Tre Parimet Themelore)	Dituria	Katër Pikat e Rëndësishme dhe argumenti i tyre (Surja Asr)
"Thërret dituria për vepër, nëse i përgjigjet ajo ngel, përndryshe ajo ikën" 'Dhe dijetari që nuk vepron me diturin e tij do të dënohet para adhuruesit të idhujve'.	Veprimi me të	
Kushtet e Thirrjes (davitit): Singëriteti, Dituria islame, njohja e gjendjes së personit që e thërret, urtësia dhe durimi.	Thirrja në të	
Gjëja e parë në të cilën thërret është Teuhidi, ajo është thirrja e të gjithë Profetëve, pra shkalla më e lartë e thirrjes është Teuhidi dhe lënia e Shirkut.		
Durimi për t'iu bindur Allahut siç është "Namazi", durimi ndaj mëkateve për të mos i vepruar ato, siç është "kamata", dhe durimi gjatë fatkeqësive, siç është "varfëria".	Durimi	
Durimi në kërkimin e diturisë, pastaj në veprimin me të dhe pastaj në Davet (Thirrje).		
Teuhidi i Zotërimit dhe Teuhidi i Emrave dhe Cilësive	Tri çështjet e rëndësishme	Tre Parimet Themelore (Në përmbledhje janë: 'Pyetjet e Varrit', argumentet e tyre, pse mësojmë Teuhidin? Pse i studiojmë tre parimet themelore? Cila është dobja e studimit të tyre?
Teuhidi i Adhurimit (Singëriteti), Allahu nuk është i kënaqur që ndokush të shoqërohet me Të në adhurimin e Tij; qoftë engjëll, apo profet.		
Distancimi nga shirku dhe njerëzit e tij; me zemër (urrejtja e mosbesimtarëve), me gjuhë ("Thuaj:" O mohues, unë nuk adhuroj atë që adhuron") dhe me veprime (duke mos marrë pjesë në festat, manifestimet e tyre dhe duke mos i imituar).		

(Hanifi): Është feja e cila anashkalon shirkun dhe orientohet nga Njeshmëria dhe Singjeriteti.	Arsyeja pse mësojmë Teuhidin	Tre Parimet Themelore (Në përmbledhje 'Pyetjet e Varrit'), provat e tyre, pse studiojmë Teuhidin? Pse i studiojmë tre parimet themelore? Cila është dobja e studimit të tyre?
Teuhidi gjuhësisht: të veçosh diçka Fetarisht: Të veçosh Allahun me atë që është specifike për Të: Zotërimi, Adhurimi ndaj Tij, Emrat dhe Cilësitë e Tij. Llojet e tij janë tre:		
1. Teuhidi i Zotërimit: Të veçosh Allahun me veprimet e Tij, veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i Universit 2. Teuhidi i Adhurimit: Veçimi i Allahut me veprat e robërve. 3. Teuhidi i Emrave dhe Cilësive të Allahut: Të veçuarit e Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Vetën në Librin e Tij ose në thëniet e të Dërguarit të Tij ﷺ, kjo duke e pohuar atë që Ai ka pohuar për Vetën dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Vetën: pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasuar.		
Shirk është adhurimi i diçkaje tjetër përveç Allahut, ose së bashku me Të. Është mëkati më i madh në tokë	Tre Parimet Themelore	
Njohja e Allahut të Lartësuar: Kush është Zoti yt? Si e njohe Allahun? Zoti është ai që duhet adhuruar, llojet e adhurimeve, dispozita për atë që dedikon ndonjë adhurim për dikënd tjetër përveç Allahut me argument.		
Njohja e fesë islame me argumente, definicioni i Islamit, shkallët e fesë, shtyllat e Islamit, definicioni i Shehadetit, shtyllat e Besimit, degët e Besimit, Ihsani, argumenti për shkallët e fesë		
Njohja e të Dërguarit: prejardhjen e tij, lindjen, moshën, profetësia dhe dërgesa e tij, vendi i tij, urtësia e dërgimit të tij, koha që ai ftoi në Teuhid, ngritja e tij në qiej, ku dhe kur namazi u obligua mbi muslimanët? Shpërngulja, dispozita dhe koha e tij. Kur u zbrit pjesa tjetër e legjislacionit? Periudha e Thirrjes, vdekja e tij, çfarë përmban feja me të cilën ka ardhur, përfshirja e profetësisë së tij gjithë njerëzit dhe xhinët, plotësimi i fesë dhe përsosja e dhuntisë.		

Ringjallja pas vdekjes dhe Llogaria për veprat, mosbesimi i atyre që e mohojnë ringjalljen, misioni i të Dërguarve dhe Thirrja e tyre, i dërguari i parë dhe i fundit, dy shtyllat e Teuhidit: mohimi i Tagutit dhe besimi në Allahun, definicioni i Tagutit, kokat e Tagutëve, përshkrimin se si të mohohet Taguti, kuptimi i thënies "La ilahe il-Allah", islami është kreu i çështjes, shtylla e fesë është namazi, kulmi i fesë është përpjekja në rrugë të Allahut (Xhiahadi).			Përmblyje		
Bëhet me ato që janë përmendur në Suren El Asr (Dituria, veprimi me të, thirrja në të dhe durimi).		Xhiahadi ndaj vetes			Llojet e Xhiahadit (Përpjekjes)
Shirku i madh (nxjerr nga islami) dhe shirku i vogël.	Dyshimet	Xhiahadi ndaj Shejtanit			
Inovacionet (shpikjet) në fe.					
Mëkatet e mëdha (ç’do mëkat që ka një dënim të veçantë)	Epshet				
Mëkatet e vogla (ç’do ndalim që nuk ka një dënim të veçantë)					
Me zemër, fjalë, vepra dhe pasuri			Xhiahadi ndaj Jobesimtarëve dhe Hipokritëve		
Me zemër, fjalë dhe vepra		Xhiahadi ndaj padrejtësive dhe shpikjeve			
Eshtë ç’do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë (siç janë gurët dhe drurët), duke e pasuar atë (siç janë dijetarët e këqinjë) apo duke iu bindur (bindja e prijësve në mëkate). Tagutat janë të shumtë, por kokat e tyre janë pesë: Ibliisi, mallkimi i Allahut qoftë mbi të, kush adhurohet dhe ai është i kënaqur me këtë adhurim. Kush i fton njerëzit në adhurimin e vetvetes, kush pretendon se di diçka nga e fshehta. kush gjykon me tjetër gjë përveç asaj që ka zbritur Allahu..			Tagut		
Allahu e di më së miri salavatet dhe selamet qofshin mbi Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.					

Test rreth Parimeve Themelore

Zgjidhni përgjigjen e saktë mes kllapave.

- 1- Autori i Tre Parimeve Themelore është: (Muhammed ibn Sulejman Temimi - Muhammed ibn AbdulVehab - gjithë më sipër).
- 2- Tre Parimet Themelore janë shkurtimisht pyetjet e varrit (E vërtetë – E gabuar).
- 3- Autori lutet për lexuesin në këtë libër (dy vende - tre vende).
- 4- Librat e autorit dallohen për (fjalorin e lehtësuar, përgjithësimin pastaj detajimin - argumentet nga Kurani dhe Suneti - lutjet ndaj nxënësit të dijes - refuzimet ndaj dyshimeve bashkëkohore - komentet e shumta - sjelljen pyetjeve të rëndësishme pastaj përgjigjen ndaj tyre - pranimin që Allahu u ka bërë librave të autorit tek njerëzit- të gjitha më lart).
- 5- Tre Parimet Themelore mund të ndahen në (5 - 6) kapituj.
- 6- Mësimi i Teuhidit është një (detyrim i përbashkët - detyrim individual).
- 7- Dëshmia për katër pikat e rëndësishme është Surja (El Asr - El ihlas).
- 8- Kushdo që mëson, por nuk vepron me të, imiton (të krishterët - hebrejnëjtë - të gjithë më lart).
- 9- Durimi ndahet në (dy - tre) pjesë.
- 10- Kuptimi i deklaratës së imam Shafiut për suren El Asr është: (mjafton për ngritjen e argumentit - mjafton për të gjitha Suret e tjera të Kuranit).
- 11- Kushdo që beson vetëm në një nga llojet e Teuhidit, nuk konsiderohet të jetë Njësues (E vërtetë - E gabuar).
- 12- Distancimi nga shirku dhe njerëzit e tij bëhet me (zemër, fjalë dhe vepra - duke u distancuar nga veprimet dhe ata që i bëjnë ato - të gjitha më lart).

- 13- Kuptimi i “vendfaljet” në thënien e Allahut: "Sigurisht që “vendfaljet” i përkasin Allahut" është: (xhamitë e ndërtuara - pjesët e trupit me të cilat bëjmë sexhde - e gjithë toka- të gjitha më lart).
- 14- Rruga e të parëve tanë të mirë është (së pari argumentohen pastaj, formojnë bindje - së pari formojnë bindje, pastaj argumentohen).
- 15- Të devijuarit nga dijetarët muslimanë imitojnë (hebrenjtë - të krishterët).
- 16- Të devijuarit nga adhuruesit muslimanë imitojnë (hebrenjtë - të krishterët).
- 17- Tri pikat e rëndësishme janë Tre Parimet Themelore (E vërtetë – E gabuar).
- 18- Lutja ndahet në (lutja e adhurimit dhe lutja e kërkesës - lutja me gjuhën e gjendjes dhe lutja me gjuhën e shprehjes).
- 19- Lutja e kërkesës ndahet në (dy - katër) pjesë.
- 20- Njerëzit sa i përket marrjes së shkaqeve janë ndarë në: (dy ekstreme dhe mesatarë – shkaqe që janë shirk i madh, shirk i vogël apo të lejuara).
- 21- Është e lejueshme të kërkohet ndihmë prej krijesave (pa kufizim - në atë që ata mund ta bëjnë - me katër kushte).
- 22- Kuptimi i 'La ilahe il-lAllah' është: (Allahu është i aftë të krijojë - nuk ka të adhuruar përveç All-llahut – nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç All-llahut – të gjitha).
- 23- Uniteti i feve është: (e lejuar – mëkat i madh - kufr).
- 24- Argumentet për ekzistencën e Allahut janë (shumë - katër).
- 25- A kanë zemër engjëjt? (Po - Jo).
- 26- Raporti midis besimit dhe Teuhidit është: besimi është i përgjithshëm dhe Teuhidi është pjesë e saj (E vërtetë – E gabuar).
- 27- Shtyllat e besimit janë (5 - 6 - 8).

- 28- Idhujtarët ia kushtojnë një pjesë të adhurimit të tyre Allahut (E vërtetë – E gabuar).
- 29- Ai që adhurohet përveç Allahut, ndërkohë që nuk është i kënaqur me këtë, është (një Tagut, nuk është një Tagut).
- 30- Të veçuarit e Allahut me rregullimin e universit dhe zbritjen e shiut është prej Teuhidit të ... (Adhurimit - Zotërimit - Emrave dhe Cilësive).
- 31- Ajo që e rrënon themelin e Teuhidit është (shirk i madh - shirk i vogël - risitë).
- 32- Obligimi më i madh është që t'u bindemi prindërve (E vërtetë – E gabuar).
- 33- Mëkatet më të mëdha janë kurorëshkelja / kurvëria dhe vrasja e një shpirti që Allahu e ka ndaluar vrasjen e tij (E vërtetë – E gabuar).
- 34- Mi'raxhi është udhëtimi i Profetit ﷺ, nga Meka në Jeruzalem.(E vërtetë - E gabuar)
- 35- Profeti ﷺ u dërgua (për popullin e tij - për të gjithë njerëzit)
- 36- Profeti ﷺ (ka vdekur - profetët nuk vdesin).
- 37- Kushdo që mohon Ringjalljen ka bërë Kufr (të madh - të vogël).
- 38- Feja e Profetëve (është një - ç'do Profet ka fenë e vet).
- 39- Hixhreti është (i pavlefshëm pas çlirimit të Mekës - i vlefshëm deri në Ditën e Gjykimit).
- 40- Hixhreti është (shpërngulja nga një vend jobesimtarë në një vend islam - lënja e asaj që Allahu e ka ndaluar).
- 41- Feja e islamit është e plotë me përjashtim të ëndrrave të të drejtëve - (E vërtetë – E gabuar).

- 42- Dedikimi i çfarëdo lloj adhurimi dikujt tjetër përveç Allahut është (shirk i madh – shirk i vogël).
- 43- Është e domosdoshme që të bëjmë dallimin midis veprës dhe vepruesit (E vërtetë -E gabuar).
- 44- Profeti (Nebij) i parë është (Nuhu ﷺ - Ademi ﷺ)
- 45- Profeti ynë ﷺ është (profet - i dërguar).

Përputhni Listën A me Listën B

Lista A	#	#	Lista B
Teuhidi gjuhësisht		1	Ahmedi ka thënë: "Kur të shoh një jobesimtar, i mbylli sytë nga frika se po shoh armikun e Allahut"
Teuhidi fetarisht		2	Përfshin besimin në gjithçka që do të ndodhë pas vdekjes
Teuhidi i adhurimit		3	Është shprehje me gjuhë, bindje me zemër, veprim me gjymtyrë, shtohet me vepra të mira dhe pakësohet me mëkate
Teuhidi i Zotërimit		4	Islami, Imani dhe Ihsani
Teuhidi i Emrave dhe Cilësive		5	Për Allahun dhe për të tjerët përveç Allahut
Hanifi		6	E obligueshme, e lejuar dhe e ndaluar
Thirrja dhe urdhëri i parë në Kuran		7	Fetare dhe universale
Ortaku (Nidd)		8	Pyetjet e varrit
Khashjeh		9	Dituri, vepër, thirrje dhe durim
Teuekul		10	Singeriteti dhe ndjekja e Sunetit
Dy kushtet për pranimin e veprave		11	Varësia e vërtetë ndaj Allahut e shoqëruar me lidhje të fortë ndaj Tij, duke mos i anashkaluar shkaqet e ligjësuara.
Përmbledhje e katër pikave të rëndësishme		12	Është frika e bazuar në dituri për madhësitinë e atij që i frikësohesh dhe fuqinë e plotë të tij

Përmbledhje e tri pikave të rëndësishme		13	Është i ngjashmi, i përafërti, i shëmbëllyeshmi
Përmbledhje e Tre Parimeve Themelore		14	Në Suren El Bekare
Shkaqet ndahen në:		15	Është feja e cila është e distancuar nga shirku, e orientuar nga Sinqeriteti, Teuhidi dhe Besimi
Zotimet ndahen në:		16	Veçimi i Allahut me atë që Ai e ka emëruar dhe përshkruar Vetën në Librin e Tij ose në thëniet e të Dërguarit të Tij ﷺ. Kjo bëhet duke pohuar atë që Ai ka pohuar për Vetën dhe duke mohuar atë që Ai e ka mohuar për Vetën pa e shtrembëruar kuptimin e tyre, pa i mohuar ato, pa i përshkruar ato dhe pa i përngjasu me cilësitë e krijesave.
Kurbani ndahet në:		17	Të veçosh Allahun me adhurim
Frika ndahet në:		18	Veçimi i Allahut si Krijues, Sundues dhe Menaxhues i universit.
Islam		19	Veçimi i Allahut me atë çfarë është specifike për të.
Nivelet e fesë		20	Të veçosh diçka
Imani (Besimi)		21	Lindja e diellit nga perëndimi ose afrimi i vdekjes
Besimi në Ditën e Fundit përbëhet nga:		22	Është ç' do gjë në lidhje me të cilin njeriu i ka kaluar kufijtë duke e adhuruar atë duke e pasuar atë apo duke iu bindur.
Prej realizimit të distancimit nga shirku është		23	Teuhid i Zotërimit, i Emrave dhe Cilësive, i adhurimit dhe largimi i vetes nga Shirku dhe njerëzve e tij
Koha kur pendimi nuk është më i vlefshëm		24	Dorëzimi (nënshtrimi) ndaj Allahut me teuhid (me njësim) dhe nënshtrimi ndaj Tij me bindje si dhe largimi prej idhujtarisë (shirkut) dhe idhujtarëve.
Tagut		25	Ajo që adhurohet përveç Allahut dhe ka një formë fizike të tillë si idhujt etj.

Katër Parimet

بسم الله الرحمن الرحيم

Të gjitha lavdërimet dhe falenderimet i takojnë Allahut, Atë e falenderojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë.

Kërkojmë strehim tek Allahu nga e keqja e vetes dhe nga e keqja e veprave tona. Këdo që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë dhe këdo që Ai e devijon askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut i Cili është i vetëm, pa partnerë, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

Hyrje

Autori i këtij libri

Dijetari i islamit dhe ripërtëritësi i thirrjes në Teuhid (njëshmëri të Allahut), imam Ebu Husejn Muhammed ibn Sulejman Temimi. U lind më 1115H dhe vdiq në 1206H

“Katër Parimet” është teksti i dytë që mësohet gjatë vargut të teksteve për nxënësin e diturisë. Këtij teksti i është kushtuar rëndësi për disa shkaqe, prej tyre:

Ndjekja e shembullit të dijetarëve të gjeneratave të arta

Këshilla e dijetarëve tanë për mësimin e tij

Sepse është shkurtesë e librit: “Largim të dyshimeve”


Në të ka refuzim për idhujtarët e kohës sonë

Fillohet me të para fillimit me librin “Largim të dyshimeve”, në mënyrë që mos të kaplojë studentin ndonjë dyshim.



Përmbajtja e Katër Parimeve

Ndahet ky libërth në tri pjesë:



Së pari: Hyrja (Shenjat e lumturisë)

Në emër të Allahut të Gjithmëshirëshmit MëshirëPlotit (1)

Lus Allahun, më Bujarin, Zotin e Fronit Madhështor, që të bëj nga të afërtit e Tij në këtë botë dhe në Jetën e Përtejme (2), dhe të bëjë Mubarek (të dobishëm) kudo që të jesh (3).

(1) Shkaku që autori filloi tekstin me emrin e Allahut

1. Duke ndjekur shembullin e librit të Allahut dhe të Profetëve (paqja qoftë mbi ta)

2. Ndjekja e shembullit të paraardhësve tanë të drejtë nga dijetarët e islamit; ata gjithmonë fillonin librat e tyre në emër të Allahut

3. Kërkim i bekimit (rritje në mirësi) prej Allahut, më Fisnikut.

(2) Pas përmendjes së emrit të Allahut, autori filloi hyrjen me lutje ndaj kërkuesit të diturisë siç e ka zakon, ky është fakt që tregon zellin e tij dhe dashurinë e tij për kërkuesit e diturisë, duke lutur Allahun që ata ti kaplojë çdo mirësi.

(3) Të afërtit e Allahut janë ata që kanë bashkuar midis besimit dhe devotshmërisë:

Ka thënë dijetari i islamit ibn Tejmiye: "Kush është besimtarë i devotshëm ai është i afërt i Allahut (i dashur i Tij)"; argument për këtë është thënia e Allahut (kuptimi i tij):


"Vërtetë për të afërtit e Allahut nuk ka frik, e as nuk kanë për ç'farë të brengosen, ata të cilët besuan dhe ishin të devotshëm." [Junus : 62; 63]

Mirësia (bereqeti) është shtimi dhe zhvillimi.

"Teberruk" është: kërkimi i bereqetit.

"El Mubarek" është ai që i shihet mirësia kudo që është.

"Teberruk" ndahet në dy kategori:



(1) Mirësia është provë dhe argumentet për këtë janë të shumta, prej tyre:


"Ne do t'ju provojmë ju me të keqen dhe me të mirën" (21:35)

"Kur (Sulejmani) e pa të vendosur para tij (fronin e Belkisës), tha: "Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Fisnik." (27:40)

"Për sa i përket njeriut, kur Zoti i tij e sprovon atë, duke e ngritur lart dhe duke i dhënë mirësi, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar." (89:15)

Po ashtu hadithi: **"Tre persona nga bijtë e Izraelit dëshirojnë Allahu që ti sprovtojë..."**

Mirësia (dhuntia) ndërlidhet me Njeshmërinë e Zotërimit dhe Njeshmërinë e Adhurimit dhe falenderimi i saj ndahet në dy kategori:



Dhe që të bëjë nga ata që kur sprovohen durojnë (1), dhe kur mëkatojnë kërkojnë falje

(1) Sepse durimi është obligim me konsensusin e të gjithë muslimanëve.

Njerëzit gjatë goditjes së fatkeqësive në këtë botë ndahen në katër kategori:


I hidhëruar

Durimtar

I kënaqur

Falënderues

1. **Hidhërimi** ndaj përcaktimit është haram, dhe prej mëkateve të mëdha, e ajo bëhet me:



- **Hidhërimi** me zemër: Ka thënë ibn Kajimi disa fjalë që kuptimin e kanë: "Disa njerëz nuk kanë guxim që ta shprehin hidhërimin me gjuhët e tyre, mirëpo shpirti i tij i cili është midis dy skajeve të tij dëshmon për këtë, duke menduar keq për Zotin e tij, duke thënë: më ka bërë padrejtësi Zoti im, më ka privuar Zoti im...etj. "
 - Hidhërimi me gjuhë: bëhet duke bërtitur apo duke vajtuar, apo duke thirrur mjerim, mallkim apo duke ofenduar.
 - Hidhërimi me gjymtyrë: bëhet duke i goditur faqet, duke i shqyer rrobat, apo duke i nxjerr flokët.
2. **Durimi** (sabri): është obligim, me unanimitetin e muslimanëve. Është obligim që reflektohet në zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.
Thotë imam Ahmed: "është përmendur durimi në Kuran në më shumë se nëntëdhjetë vende, ai është obligim me konsensusin e Ummetit, dhe është gjysma e besimit, sepse besimi përbëhet nga dy pjesë, gjysma durim dhe gjysma falënderim." (Mederixh esSelikin e ibn Kajjimit).
3. **Kënaqësia**: është e pëlqyer dhe është shkallë më e lartë se sa durimi.
4. **Falënderimi**: është shkalla më e lartë dhe më e plota.

Dije, Allahu të udhëzoftë që t'i bindesh Atij, se *Hanifija* është feja e Ibrahimit: Kjo është që ta adhuron Allahun duke e praktikuar fenë vetëm për Të, siç tha Ai:

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë” (1) [Edh Dharijat, 56].

Kur ju të pranoni se Allahu ju ka krijuar për adhurimin e Tij, atëherë ta dini se adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, ashtu siç namazi nuk konsiderohet namaz, përveçse nëse është i shoqëruar me pastrim (*tahara*). Kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e zhvlerëson atë ashtu siç papastërtia e zhvlerëson pastërtinë.

Pra kur ta dini se nëse shirku hyn në adhurimin tuaj ai e çorodit atë, i anulon të gjitha veprat dhe ai që e bën atë përgjithmonë është në Xhehenem, atëherë ju do ta kuptoni çështjen e detyrueshme dhe më të rëndësishmen për ju: njohjen e këtij fakti, me qëllim që Allahu t'ju shpëtojë nga skëterra e të bërit shirk ndaj Tij, për të cilën Ai, më i Lartësuari, tha,

“Vërtet, Allahu nuk fal që t'i shoqërohen Atij ortakë në adhurim, por Ai i fal përveç kësaj (çfarëdo tjetër) për atë që dëshiron.” [en-Nisa 4:116]

Kjo dituri përfshin katër parimet të cilat Allahu, më i Lartësuari, i ka përmendur në Librin e Tij.

Parimi i parë është që të dish se jobesimtarët, të cilët i Dërguari ﷺ i luftoi, e pranorin se Allahu, më i Lartësuari, ishte Krijuesi dhe Rregulluesi i të gjitha çështjeve, por kjo nuk i futi në Islam dhe dëshmi për këtë është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

“Thuaj: Kush ju furnizon nga qielli dhe nga toka? Apo kush posedon të dëgjuarit dhe të parit? Dhe kush e nxjerr të gjallin prej të vdekurit dhe e nxjerr të vdekurin prej të gjallit? Ata do të thonë: “Allahu.” Thuaj: “A s’do të frikësoheni atëherë nga dënimi i Allahut (për atë se i përshkruani rival në adhurim Allahut)?” (2) [Junus 10:31]

(1) Autori sqaroi shkakun pse ne mësojmë Teuhidin?

(2) jobesimtarët tek të cilët është dërguar Muhamedi ﷺ kanë pranuar Allahun si Krijues dhe Zot, megjithatë i Dërguari ﷺ i luftoi ata; pra hasmëria midis tyre dhe Profetit ﷺ ishte në njësimin e Allahut në adhurim, andaj kushdo që dedikon ndonjë adhurim ndaj dikujt tjetër përveç Allahut ai është idhujtar, jobesimtarë.

Parimi i dytë: Ata (idhujtarët) thonë: Ne nuk i lutemi dhe nuk iu drejtohem atyre vetëm se për të kërkuar afrimin (tek Allahu) dhe ndërmjetësimin (përmes tyre tek Allahu).

Dëshmia kundër kerkimit të afërsisë (përmes eulijave) është thënia e Tij,

“Dhe ata që marrin mbrojtës krahas Tij (thonë): “Ne i adhurojmë ata vetëm që të na ofrojnë tek Allahu.” Vërtet, Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çka ata kundërshtoheshin. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe jobesimtar.” (1)
[ez-Zumer 39:3]

Dëshmia kundër ndërmjetësimi (përmes eulijave) është thënia e Tij, më të Lartësuarit:

“Dhe ata adhurojnë përveç Allahut gjëra të cilat nuk u sjellin as dëm as dobi, dhe thonë: “Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.”
[Junus 10:18]

Ndërmjetësimi është dy llojesh:

- Ndërmjetësimi i mohuar dhe
- Ndërmjetësimi i pohuar. (2)

(1) Argumentohen ithtarët e shirkut dhe mosbesimit me atë që ata nuk i adhurojnë këta të cilët i lusin dhe se nuk iu drejtohen atyre vetëm se për të kërkuar afrim dhe ndërmjetësim, mirëpo ata me këtë kanë merituar që i Dërguari ﷺ ti bëjë tekfir (ti shpallë si jobesimtarë) dhe ti luftojë ata.

(2) Ndërmjetësimi (shefati) gjuhësisht rrjedh prej bashkëngjitjes, kurse fetarisht d.t.th: ndërmjetësimi ndaj ndokujt për ti sjellë ndonjë dobi, apo për ti larguar ndonjë dëm.

Llojet e ndërmjetësisimit (Shefatit)

I pohuar

Është ajo që kërkohet nga Allahu.

Kushtëzohet për të:

- Leja e Allahut për ndërmjetësimin.
- Kënaqësia e Tij ndaj ndërmjetësuesit dhe
- ndaj të ndërmjetësuarit.

Në atë që ka mundësi krijesa

Lejohet me katër kushte:

- Të jetë i gjallë.
- Të jetë prezentë.
- Të jetë i aftë.
- të merret si shkak.

I mohuar

Është ajo të cilën e ka mohuar Kurani, është ajo që kërkohet prej dikujt tjetër përveç Allahut për çfarë nuk ka mundësi askush përveç Allahut, ky llogaritet shirk i madh.

Pra ndërmjetësimi i mohuar është ai që kërkohet prej dikujt tjetër përveç Allahut në atë çfarë nuk ka mundësi ta realizojë askush përveç Allahut; argument për këtë është:

"O ju që keni besuar, jepni prej asaj që u kemi furnizuar, para se të vij një ditë kur nuk do të ketë as shitje, as miqësi e as ndërmjetësim! Mosbesimtarët, ata janë mizorët!"

2:254

Ndërmjetësimi i pohuar: është ajo që kërkohet prej Allahut, ndërmjetësuesi nderohet me ndërmjetësim (nga Allahu si shkak që ia ka dhënë mundësinë e ndërmjetësimit sh.p), kurse ai për të cilin ndërmjetësohet është: ai i cili Allahu ia ka pëlqyer fjalët e tij dhe veprat e tij pasi që ti ketë dhënë leje, siç ka thënë i Lartësuari:

"Kush mund të ndërmjetësojë te Ai, përveç se me lejen e Tij?" 2:255

Parimi i tretë (1) është që Profeti ﷺ

takoi njerëz që dallonin në adhurimin e tyre. Në mesin e tyre ishin njerëz që adhuronin engjëj, disa që adhuronin profetë dhe njerëz të drejtë, si dhe të tjerë të cilët adhuronin gurë, drurë, diellin dhe hënën. I Dërguari i Allahut ﷺ i luftoi ata dhe nuk bëri dallim mes tyre.

Dëshmi është thënia e Allahut, më të Lartësuarit,

"Dhe luftoini ata derisa të mos ketë më fitne (trazira) dhe tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun." [2:193]

Dhe dëshmi se dielli dhe hëna (adhurohen) është thënia e më të Lartësuarit:

"Dhe prej Shenjave të Tij janë nata dhe dita, si dhe dielli dhe hëna. Mos i bëni sexhde diellit dhe hënës, sexhde bëni vetëm Allahu i Cili i krijoi ato, nëse vetëm atë e adhuroni" [41:37]

Dhe dëshmi që engjëjt nuk adhurohen është thënia e më të Lartësuarit,

"Dhe as që ju urdhëron ai (pejgamberi) që të adhuroni engjëjt, as pejgamberët për zota. Vallë, a ju urdhëroi ai juve mosbesimin pasi që ju jeni muslimanë?"

[3:80]

(1) Kjo rregulle është argument shumë i qartë për refuzimin e atyre që thonë që shirku bëhet vetëm duke i adhuruar idhujt, argumentet fetare kanë ardhur si për adhuruesit e idhujve, ashtu edhe për të adhuruarit e tjerë.

I Dërguari ﷺ nuk ka bërë dallim midis tyre, mirëpo që të gjitha i ka llogaritur si Taguta (të adhuruar pa të drejtë), i ka luftuar të gjithë pa dallim, në mënyrë që feja t'i kushtohet vetëm Allahut të Lartësuar.

Dëshmi se pejgamberët adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:

“Dhe kur Allahu të thotë (në Ditën e Ringjalljes) “O Isa, biri i Merjemes, a u ke thënë ti njerëzve, “Më adhuroni mua dhe nënën time si dy zota krahas Allahut”. Ai do të thotë, “Lavdi të qoftë ty! Nuk më takon mua ta them atë që s’kam të drejtë (ta them). Sikur të kisha thënë një gjë të tillë, Ti me siguri do ta dije atë. Ti e di se çfarë ka në mua ndonëse unë nuk e di se ç’ka në Ty. Vërtet, Ti je i Gjithëdijsëm për tërë atë që është e fshehur.” [5:116]

Dëshmi se njerëzit e drejtë adhurohen është thënia e më të Lartësuarit:

“Të tillët (zotat) që këta po lusin (pos Allahut), vetë ata kërkojnë afrimin (tek Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të Zotit tënd është për t’iu ruajtur..” [17:57]

Dëshmi se gurët dhe drunjtë adhurohen është thënia e Tij, më të Lartësuarit,

“ ju i morët në konsiderim el-Lat dhe el-Uza. Dhe Menatin, të tretin tjetër?” [53:19-20]

Dhe hadithin e Ebu Uekid el-Lejthit (radiAllahu anhu) i cili tha: **“Ne u nisëm me Pejgamberin (salAllahu alejhi ue selam) për në Hunejn dhe ishim të rinj në Islam. Idhujtarët kishin një dru të cilit i përkushtoheshin dhe në të cilin i varnin armët e tyre, dhe atë dru e quanin ‘Dhat Enuat’. Ne kaluam pranë një druri dhe thamë, “O i Dërguar i Allahut, na cakto edhe neve një Dhat Enuat ashtu siç ata kanë një Dhat Enuat. Ai tha, “Allahu Ekber! Allahu Ekber! Allahu Ekber! Pasha atë, në Dorën e të cilit është shpirti im, këto janë rrugët. Kjo që thatë është e njëjtë me atë që i thanë Benu Israilët Musait,**

“Na e bëj dhe neve një zot sikurse zotat e tyre.” Ai tha, “Vërtet ju jeni njerëz injorantë.” [7:138]

[Transmetuar nga et-Tirmidhi (2180) i cili tha se hadithi është Hasen Sahih, dhe Ahmedi (5/218), Ibn Ebi Asim në es-Sune (76), Ibn Hiban në Sahinë e tij (6702) dhe që bërë autentik nga Ibn Haxher në el-Isabe (4/216).

Parimi i katërt është që idhujtarët e kohës sonë janë më të këqinj në shirkun e tyre se idhujtarët që ishin para tyre. Kjo-sepse ata që ishin para tyre bënë shirk gjatë kohës së rehatisë por e bënë adhurimin e tyre vetëm për Allahun kur gjendeshin në vështirësi. Mirëpo, shirku i idhujtarëve të kohës sonë është i vazhdueshëm, gjatë gjendjes së rehatisë dhe vështirësisë.

Dëshmi është thënia e Tij :

“Dhe kur ata hipin në anije e lusin Allahun duke e pasur besimin e pastër vetëm për Të, ndërsa kur Ai i sjellë ata të sigurt në tokë, vini re, ata i japin të tjerëve një pjesë të adhurimit të tyre.”
(1) [29:65]

Dhe Allahu, i Lartësuari, e di më së miri. Lutjet dhe paqja qofshin mbi Muhammedin, familjen e tij dhe Shoqëruesit e tij.

Autori në këtë parim ka sqaruar qëndrimin e rrezikshëm të idhujtarëve të kohës sonë, duke e marrë parasysh që e kanë shirkun më të rëndë se sa idhujtarët e mëhershëm, sepse idhujtarët e kohës sonë, i bëjnë shirk Allahut në mirëqenie dhe në vështirësi, kurse idhujtarët e kohës së mëparshme kanë bërë shirk vetëm gjatë mirëqenies, ndërsa gjatë vështirësive e kanë njohur Allahun dhe Njëshmërinë e Tij.

Përderisa jobesimtarët tek të cilët është dërguar Profeti ﷺ e kanë pasur shirkun më të ulët se këta të kohës tonë dhe megjithatë Allahu i ka shpallur si jobesimtarë, atëherë çfarë mendon lidhur me ata që shirkun e kanë të vazhdueshëm në mirëqenie dhe në vështirësi? S’ka dyshim, ata janë jobesimtarë në formë më parësore.

Kërkimi i Xhennetit nuk bëhet vetëm se prej Allahut, sepse është Ai që e posedon atë, ashtu është edhe çështja e furnizimit (rizkut), nuk kërkohet vetëm se prej Allahut, prandaj është e domosdoshme të lidhemi me Allahun e jo me të tjerët.	Ndërlidhet me Teuhidin Rububije (Njësimin në Zotërim).	Falënderimi i mirësisë	Mirësia është provë, argumenti për këtë është: "Ne do t'ju sprovojmë ju me të keqen dhe me të mirën"	Kur i jepet falënderon	Shenjat e lumturisë	Hyrja dhe aty përmenden shenjat e lumturisë	Katër parimet, ato janë përmbledhje e librit "Largim i dyshimeve"
Falënderon me zemër: duke e pranuar që çdo dhunti që e posedon është prej Allahut e jo prej ndokujt tjetër	Ndërlidhet me Teuhidin Uluhije (Njësimin e Allahut në adhurim)						
Falënderon me gjuhën e tij: "Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues."							
Falënderon me gjymtyrët e tij: Duke i shfrytëzuar ato mirësi për të falenderuar Begatuesin, ç'do mirësi falënderohet sipas natyrës së saj, falënderimi i mirësisë së pasurisë bëhet duke e shpenzuar në bindje ndaj Allahut, falënderimi i mirësisë së diturisë bëhet duke e shpërndarë atë e kështu me radhë.							
I hidhëruar: dispozita për të është: prej mëkateve të mëdha, hidhërimi bëhet me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.	Situatat e njerëzve gjatë goditjes së fatkeqësive	Kur të sprovohet duron					
Durimtarë: dispozita e durimit është : obligim, të gjithë dijetarët janë të një fjale, bëhet me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë, durimi është i hidhur siç e ka 							

emrin, mirëpo përfundimin e ka më të ëmbël se mjalti.			
I kënaqur: dispozita e tij është e pëlqyer, për shkak të kënaqësisë së plotë që e ka ndaj Zotit të tij e din që ç'do gjë që e godet është prej Allahut dhe se çdo gjë që Allahu ia përcakton robit të Tij besimtarë është mirë për të.			
Falënderues: ajo është shkalla më e lartë, dhe ajo është gjëja më e pëlqyer, dhe këtë nuk e arrin kush përveç robërve të Allahut që janë falënderues të vërtetë.			
Kur bën mëkat kërkon falje.			
Hanifija: është feja e pastër e Ibrahimit, që Allahu të ka krijuar për adhurimin e Tij. Adhurimi nuk merret në konsideratë si i tillë, përveçse nëse shoqërohet me Teuhid, kështu që kur shirku hyn në adhurim, ai e zhvlerëson atë dhe i anulon veprat dhe ai bën që pronari i tij të jetë përgjithmonë në Zjarr, atëherë bëhet e qartë që gjëja më e rëndësishme është njohja e këtij fakti.	Pse e mësojmë Teuhidin dhe rrezikun e shirkut?		
Parimi i parë: Mosbesimtarët të cilët i luftoi i Dërguari ﷺ e kanë pranuar Zotin si Krijues, mirëpo nuk e kanë veçuar Atë me adhurim dhe ky pranim nuk i ka futur ata në islam.		Katër Parimet	
Parimi i dytë: Mosbesimtarët i kanë adhuruar idhujt për shkak të afrimit dhe të ndërmjetësimit.			
Parimi i tretë: Profeti ﷺ është shfaqur tek disa njerëz të cilët kanë qenë të ndryshëm në adhurimet e tyre dhe nuk ka bërë dallim midis këtij apo atij shirku			
Parimi i katërt: Idhujtarët e kohës sonë janë me shirk më të rëndë se sa të parët.			

Test për Katër Parimet

Emri

Sasia e memorizimit të Librit të Teuhidit

A i di përmendësh katër parimet

Puna	Argumenti nga Kurani dhe Sunneti
Mirësia është provë	
Pranimi që e bëjnë mosbesimtarët ndaj Teuhidit Rububije	
Kërkimi i afërsisë	
Ndërmjetësimi i mohuar	
Argumenti për Diellin dhe për Hënë	
Argumenti për Engjëjt	
Argumenti për Profetët	
Argumenti për njerëzit e mirë	
Argumenti për gurët dhe drurët	
Idhujtarët janë të sinqertë në vështirësi dhe bëjnë shirk në rehati	
Argumenti për Shirkun	

Shkruaj nga ajo që di lidhur me atë që vijon:

Përse e mësojmë Teuhidin?	1-	2-	3-	4-
5-	6-	7-	8-	
Përse i mësojmë Katër Parimet?	1-	2-		
3-		4-		
Ndahen katër parimet në:	1-	2-	3-	
Katër Parimet janë përmbledhje e librit				
Përse nuk e mësojmë fillimisht librin "Largim dyshimesh"?				
Shenjat e lumturisë	1-	2-	3-	
Hanifija është:				
Frytet e mësimit të Katër Parimeve				
Të afërmit e Allahut janë:	Ka thënë ibn Tejmije:			
Argument për këtë është:				
Falënderimi ndaj dhuntisë bëhet duke..., duke i shtuar kësaj shembull konkret	1-			
2-				
3-				

Si duhet të jetë lidhja e robit?				
Gjendjet e njerëzve gjatë fatkeqësive, duke e përmendur dispozitën	1-	dispozita për të:	bëhet me:	dhe dhe
	2-	dispozita për të:	bëhet me:	dhe dhe
3-	4-			
Shefati gjuhësisht dhe fetarisht				
Shefati ndahet në:	1-	2-		
Kushtet e shefatit të lejuar:	1-	2-	3-	
Dhe ndahet në:	1-	dhe ndahet në:	dhe	dhe
2-	dhe ndahet në		dhe	dhe
Parimi i parë:				
Parimi i dytë:				
Parimi i tretë:				
Parimi i katërt:				
Dispozita e veprës nëse përzihet me shirk dhe argumenti				

Komentimi i Anuluesve të islamit

Komentimi i anuluesve të Islamit

Parathënie

Vërtet, të gjitha falënderimet i takojnë Allahut të madhëruar, Atë e lavdërojmë, dhe vetëm prej Tij falje dhe ndihmë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e veteve tona dhe nga të këqijat e veprave tona.

Atë që Allahu udhëzon, nuk ka kush që ta devijojë, dhe atë që Allahu e devijon, askush nuk mund ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk ka asnjë të denjë për adhurim përveç Allahut të vetëm, pa ortak dhe dëshmoj se Muhammedi (ﷺ) është rob dhe i Dërguari i Tij. Në vijim :

"Me të vërtetë, fjala më e mirë është Libri i Allahut të Lartësuar dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ, gjërat më të këqija në fé janë shpikjet. Çdo shpikje është një risi (bidat) në Islam. Çdo risi është devijim dhe çdo devijim është në Zjarrë¹."

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا ادْخُلُوا فِي السِّلْمِ كَافَّةً وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُبِينٌ

"O ju që keni besuar! Hyni në Islam tërësisht dhe mos pasoni gjurmët e djallit, vërtet ai është për ju armik i hapur" (kur'an 2:208)

Dhe Allahu (subhannahu ua te'ala) thotë në Kuran:

أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ آمَنُوا أَنْ تَخْشَعَ قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ اللَّهِ

"A nuk ka ardhur koha për ata që kanë besuar që zemrat e tyre të përulen para përkujtimit të Allahut..." (Kur'an 57:16)

¹ Ky fjalim është nga hadithi i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) dhe njihet si hutbeja lamtumirëse dhe i Dërguari i Allahut (ﷺ) fillonte hutbën e tij, predikimet, mësimet dhe paralajmërimet me të. Shejh Albani (Allahu e mëshiroftë) ka shkruar një kërkim shkencor të dobishëm mbi këtë temë.

Fatkeqësisht Umeti i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) po vuan sot në duart e njerëzve që nuk kanë njohuri fetare, që dalin për thirrje në Islam dhe japin fetva (verdikte juridike islame).

Ky libër "شرح متن نواقض الاسلام", Komentimi i anuluesve të islamit" është një nga shkrimet më thelbësore të shkruara. Kjo paralajmëron dhe hedh poshtë rrugët e sekteve të gabuara, të cilat janë shfaqur sot në mbarë botën ku muslimanët jetojnë.

Pyetja që dikush mund të ngrejë është: Nëse gjithkush pretendon të jetë në të vërtetën, atëherë si ta dallojmë atë që realisht është në të vërtetën?

Përgjigja për këtë është: Islami me të cilin ka ardhur i Dërguari i Allahut (ﷺ) dhe Islami i Sahabëve (shokëve të tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta).

Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që ka zgjedhur (në dynja) dhe e fusim në Xhehennem. Përfundim i keq është ai.

{Kuran, En-Nisa 115}

SHPJEGIM I ANULUESVE TË ISLAMIT

Dijetari i Islamit, Muhamed ibn Abdul Uehab (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Në emër të Allahut Mëshiruesit, Mëshirëbërësit. Dije që anuluesit e islamit janë dhjetë anulues:

Së pari: Shoqërimi i ortakëve në adhurim me Allahun (shirku), Allahu thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ

“Vërtet Allahu nuk fal që ti ortakësohet dikush në adhurim, e fal poshtë tij (shirkut) për atë që do” (Kur’an 4:48)

Dhe thotë:

“...Sigurisht atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhennetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri, dhe për zullumqarët nuk ka ndihmës” (5:72).

Aty bën pjesë edhe therja e kafshëve për dikën tjetër përveç Allahut, siç është rasti i atyre që therin për Xhindët apo të vdekurit.

Së dyti: Kushdo që bën midis tij dhe Allahut ndërmjetës duke ju lutur atyre, apo duke kërkuar ndërmjetësimin e tyre apo duke ju mbështetur atyre, vetëm se ka bërë kufr (ka mohuar) me unanimitet të dijetarëve.

Së treti: Kushdo që nuk i bën tekfir (nuk i llogarit si pabesimtarë) mushrikët (idhujtarët), apo dyshon në veprën e tyre të kufrit (mosbesimit), apo e saktëson rrugën e tyre, ka bërë kufr.

Së katërti: Kush beson që ka udhëzim më të plotë se udhëzimi i Profetit (ﷺ), apo që gjykimi i ndokujt është më i mire se gjykimi i tij, siç është rasti me ata të cilët preferojnë gjykimin e Tagutëve (kokat e devijimit sh.p) para gjykit të tij, atëherë ata janë (Jobesimtarë).

Së pesti: Kushdo që urren ndonjë gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari (ﷺ) edhe nëse vepron me të, ka bërë kufr.

Së gjashti: Kushdo që tallet me diçka prej fesë së të Dërguarit (ﷺ), shpërblimit të Allahut ose dënimit të Tij, vetëm se ka bërë kufr. Allahu thotë:
 قُلْ أَلِلَّهِ وَآيَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ. لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ.

“...Thuaj: “A mos vallë me Allahun, shpalljet e Tij dhe të Dërguarin e Tij po talleni?”Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar...”
 (Kur'an 9: 65-66)

Së shtati: Sihri (magjia), duke përfshirë magjinë e ndarjes dhe magjinë e bashkimit (divorcit ose lidhjes), kushdo që e praktikon atë ose është i kënaqur me të, ka bërë kufr. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَا يُعْلِمَانِ مِنْ أَحَدٍ حَتَّى يَقُولَا إِنَّمَا نَحْنُ فِتْنَةٌ فَلَا تَكْفُرْ

“Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!” (Kur'an 2:102)

Së teti: Mbështetja e idhujtarëve dhe ndihmesa e tyre kundër muslimanëve. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَنْ يَتَوَلَّهُمْ مِنْكُمْ فَإِنَّهُ مِنْهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

“...Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit”.(Kur'an 5:51)

Së nënti: Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohet të dalin prej legjislacionit islam ashtu siç ju lejua Hidrit dalja prej legjislacionit të Musës ﷺ atëherë ai është një Kafir (Pabesimtarë).

Së dhjeti: Shmangia nga feja e Allahut duke mos e mësuar atë dhe duke mos vepruar me të. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ دُكِرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا ۚ إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنتَقِمُونَ

“E kush është më i padrejtë se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve.”

(Kur'an 32:22)

Nuk ka dallim në kryerjen e ndonjërit prej anuluesve të lartpërmendura, pavarësisht nëse dikush e ka bërë atë seriozisht apo me shaka, apo nga frika, përveç nëse është i detyruar të thotë ose të bëjë ndonjërin prej tyre. Të gjitha këto janë prej çështjeve më të rrezikshme që ndodhin më së shumti. I takon një muslimani të jetë i kujdesshëm dhe të ketë frikë se mos bie në njërin prej tyre. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo që e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm.

Paqja dhe bekimet qofshin mbi krijesën më të përsosur, Muhammedin (ﷺ) familjen dhe shokët e tij.

SHPJEGIMI

HYRJE E AUTORIT

Në Emrin e ALLAHUT, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Dije që anuluesit e islamit janë dhjetë anulues:

Përse dijetarët fillojnë librat e tyre me Bismilah (në emër të Allahut)?

Kjo është për shkak se ata ndjekin:

1. Kuranin fisnik , Profetët dhe të dërguarit (paqja qoftë mbi ta) si shembuj.

2. Hadithin: "çdo gjë që nuk fillon me Bismilah është e cunguar / ebter", edhe pse është i dobët.

3. Ndjekja e dijetarëve dhe Selefëve (paraardhësit tanë të drejtë, Allahu i mëshiroftë të gjithë ata).

4. Për të fituar bekimet e Allahut duke filluar me emrin e Tij.

Nëse një numër përmendet në Kuran ose në Hadith

Nëse e gjejmë në tekstet e Kuranit dhe Sunnetit që nuk ka diçka që e shton këtë numër, atëherë numri ka një nënkuptim, domethënë që nuk mund të shtohet. Për shembull: Shtyllat e Imanit, sikurse në Hadithin e Xhibrililit (alejhi selam).

Nëse gjejmë që ka një numër më të madh në tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit, atëherë ky numër nuk ka nënkuptim dhe ne mund të marrim një numër më të madh nga ai që ka ardhur, siç është hadithi "*Pesë janë aktet e Fitras (natyrshmërisë)*", ose "*Shmangni Shtatë Gjërat Shkatërruese*".

Pse numri i përmendur ndonjëherë nuk ka nënkuptim?

Kjo është nga metoda e përsosur e mësimeve të të Dërguarit të Allahut (ﷺ). Kjo sepse ai (ﷺ) donte t'ia lehtësonte dëgjuesit të tij kuptimin e asaj që u përmend në mesim dhe ta përvetësonin atë plotësisht në një të ardhme të afërt. Ashtu siç ka thënë i Dërguarit i Allahut (ﷺ): *"Ka tri gjëra për të cilat unë betohem, kështu që mbanjini mend ato."* Ai (ﷺ) tha: *Pasuria e një robi (të Allahut) nuk zvogëlohet me anë të bamirësisë..."*, në këtë rrugë ka ecur autori.

Pse i studiojmë këto anulues (të islamit)?

Në mënyrë që të distancohemi dhe të mos biem në to, kjo është një dobi e madhe, madje prej dobive më të mëdha. Kjo është e ngjashme me mësimin e çështjeve që zhvlerësojnë abdesin apo namazin, që të mos jetë namazi ynë i kotë. Hudhejfah ibn el jeman (radijAllahu anhu) transmeton: "Njerëzit e pyesnin të Dërguarin e Allahut (ﷺ) për të mirën, por unë e pyesja atë (ﷺ) për të keqen nga frika se ajo mund të më kapë".

Ç'farë janë anuluesit e Islamit?

Janë ato që rrënojnë Islamin dhe që janë shkak për rënien e njeriut në kufër të madh (duke dalë kështu nga Islami). Islam do të thotë dorëzim ndaj Allahut me Teuhid (Njësim) dhe nënshtrim ndaj Tij me bindje dhe distancim nga shirku dhe nga njerëzit e tij.

Kuptimi i kësaj është:

Kryerja e ndonjërit prej këtyre anuluesve nga një musliman, e bën atë të dalë nga Islami për në Kufr (i kërkojmë Allahut mbrojtje dhe shpëtim).

Pse dijetarët përdorin shprehje të ndryshme si: Zhdukës, zhvlerësues ose anulues?

Këto janë fjalë të njëjta në kuptim dhe përdoren në mënyrë që nxënësit të mos mërzhiten duke përdorur shpesh të njëjtat fjalë.

A janë dijetarët të një mendimi sa i përket këtyre anuluesve?

Përgjigjja është Po.

A janë këta anulues të kufizuar në një numër të caktuar?

Përgjigjja është Jo.

Pse u përmendën dhjetë prej tyre?

Sepse ato janë më të përhapurat, dhe që të mësohen përmendësh.

A është e mundur të përfshihen anuluesit e islamit në formë të përgjithshme?

Me bindje të zemrës Siç është: bindja që dikush tjetër përveç Allahut mund të sjell dobi.	Me fjalë siç është: fyerja e Allahut ose të Dërguarit të Tij (ﷺ) ose e fesë Islame.	Me Vepra siç është: praktikim i magjisë.	Dyshimi në mosbesimin e hebrenjve dhe të krishterëve të cilëve ju ka arritur shpallja dhe nuk kanë besuar në të.
---	---	--	--

A i ka përmendur Profeti (ﷺ) Dhjetë anuluesit? Cili është argumenti?
Po, i Dërguari i Allahut (ﷺ) i ka përmendur të gjithë këta anulues, ç' do njeri prej tyre ka argument nga Kur'ani dhe Sunneti. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

وَكَذَلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ وَلِتَسْتَبِينَ سَبِيلُ الْمُجْرِمِينَ

"Ne kështu i shpjegojmë hollësisht shpalljet, në mënyrë që të qartësohet rruga e kriminelëve". (Kur'an 6-55)

A është e lejuar për dikë që të shpallë dikë tjetër jobesimtar, nëse ai person është parë ose është njohur për kryerjen e ndonjë prej këtyre veprave anuluese të Islamit?

Jo, nuk është e lejuar. Për këtë çështje duhen konsultuar dijetarët e njohur ose Gjykata e Sheriatit Islam për të marrë një vendim për mosbesimin e dikujt. I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

"Nëse dikush i thotë vëllait të vet, O jobesimtar, atëherë me siguri njeri prej tyre është i tillë".

Kush ka shkruar prej dijetarëve lidhur me anuluesit e islamit?

Të gjithë autorët e Fikhut (Jurisprudencës) i përmendin anuluesit në kapitullin "dispozita e renegatëve". Megjithatë, autori është i pari që e shkroi në libër të veçantë.

A është e domosdoshme që të bëjmë dallim midis veprës dhe vepruesit?

Po patjetër, kjo sepse jo ç'do kush që bie në kufr bie kufri mbi të (jo çdokush që bie në vepër mosbesimi është jobesimtarë), për këtë arsye, vepra e tekfirit (deklarimit se dikush është jobesimtarë) kushtëzon ngritjen e argumentit dhe largimin e dyshimeve. Për më tepër, qëllimi i autorit (Allahu e mëshiroftë) nuk është që t'i shpallë njerëzit si jobesimtarë, porse të paralajmërojë për anuluesit e Islamit, e kjo është këshillë për Umetin.

Çfarë duhet të veprojnë ai i cili i ka mësuar anuluesit e islamit?

Duhet që të ketë kujdes të madh që të mos bie në njërin prej tyre, po ashtu ti paralajmërojë të tjerët nga rreziku i tyre, sidoqoftë, gjykimi ndaj individëve i takon dijetarëve dhe Gjykatave Islame. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ
فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët. Nëse ata largohen (nga e vërteta), thuaj: “Më mjafton Allahu, s’ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai që është Zot i Fronit të Madh”! (Kur’an 9:128-129)

Anuluesi i Parë

Shoqërimi i ortakëve në adhurim me Allahun (shirku), Allahu thotë (kuptimi i ajetit): “Vërtet Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë” (Kur’an 4:48)

Dhe Allahu thotë: “...Sigurisht atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhennetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës” (Kur’an 5:72).

Aty bënë pjesë edhe therja e kafshëve për dikën tjetër përveç Allahut, siç është rasti i atyre që therin për Xhindët apo të vdekurit.

Llojet e Shirkut

Shirku i madh

(Këtë e kishte për synim autori)

Realiteti i tij është që të besojë se dikush tjetër përveç Allahut ka sundim të fshehtë në univers, apo ka bindje që mund të sjell dobi apo të largojë dëme.

1. Nxjerr prej islamit
2. I zhduk të gjitha veprat
3. E bën të lejuar dënimin me vdekje për personin që kryen shirk dhe konfiskimin e pasurisë nga udhëheqësi (qeverija).
4. Meritimi i ndëshkimit të përjetshëm në zjarrin e xhehenemit.
5. Në tekste legjislative quhet si shirk i madh.
6. Nëse është në trajtën e shquar atëherë për qëllim është shirku i madh.

Shirku i vogël

Është bërja shkak e ndonjë gjëje që Allahu nuk e ka bërë si shkak, çdo gjë që është rrugë për tek shirku i madh është shirk i vogël.

1. Nuk nxjerr nga islami.
2. Anulon vetëm veprimin specifik.
3. Nuk i nënshtrohet konfiskimit të pasurisë ose dënimin me vdekje nga udhëheqësi (qeverija).
4. Nuk e bën të obliguar dënimin me Zjarr në formë të përhershme.
5. Në tekste legjislative quhet si shirk i vogël.
6. Nëse vjen në trajtën e pashquar.

A falet shirku i madh?

Jo, nuk falet nëse vdes në ate gjendje. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran“ : Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij,...” (Kur’an 4:48)

Nëse ai pendohet atëherë i falet për shkak të thënies së Allahut në Kuran: **“Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”** (Kur’an 39:53).

Përderisa dielli nuk lind nga perëndimi, për shkak të thënies së të Dërguarit të Allahut (ﷺ): *"Hixhreti nuk do të përfundojë derisa pendimi të përfundojë dhe pendimi nuk do të përfundojë derisa dielli të dalë nga perëndimi".*

Apo kur ti afrohet vdekja, Allahu thotë në Kuran: **“Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të këqija e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: “Unë tani me të vërtetë pendohem”**. As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm.”

Llojet e fljimeve

Kurbani që bëhet për Allahun

Kurbani i Haxhit, i Bajramit, Akikah, ose për bamirësi.

Therja që bëhet për dikë tjetër përveç Allahut me dashuri dhe madhërim:

Siç është fljimi ndaj xhindëve dhe ndaj të vdekurit. Ky është Shirk i madh.

Therja e Lejuar

Siç është: të presh mish për vete, apo që t'iu shërbesh mysafirëve, për biznes etj.

Llojet e Veprave të Ndaluar

Shirk i madh (mosbesim i madh që zhvlerëson Islamin), është mëkati më i madh.	Shirku i vogël (mosbesimi i vogël që nuk e zhvlerëson Islamin), është më i madh se mëkatet e mëdha.	Mëkatet e Mëdha: Ç'do veprim për të cilin është përmendur (në Kur'an ose Sunnet) dënim i veçantë, siç është mallkimi, apo largimi prej mëshirës, apo që vepruesi i tij është jobesimtarë, apo krahasohet me kafshët më të ulta, etj...	Mëkatet e vogla: Ç'do veprim i ndaluar për të cilin nuk është përmendur dënim specifik i veçantë në Kur'an dhe Sunnet.
---	---	--	--

Mëkatet më të mëdha

Numri i tyre: Nuk ka një numër specifik, por mund të përfshijë çdo akt që përputhet me përshkrimin e mësipërm.	Vendimi mbi atë që e kryen atë: 1. Besimtar i dobët, është besimtar me besimin e tij dhe mëkatarë me mëkatin e tij. 2. Duhet për sevapet e tij e urrehet për gjynahet e tij. 3. Nuk shoqërohet me të për aq kohë sa ai është i zhytur në mëkate të mëdha.	Nivelet e ndryshme(të mëkateve të mëdha): 1. Ka nivele të ndryshme, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: "Mëkatet më të mëdha prej më të mëdhajave".	Vendimi rreth mëkateve të mëdha 1. Vendimi është që pendimi është i detyrueshëm, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: "Nëse shmangeni mëkatet e mëdha", dhe ka thënë: "Vajtuesja nëse nuk pendohet..."
---	---	--	--

Kushdo që bën midis tij dhe Allahut ndërmjetës duke ju lutur atyre, apo duke ju kërkuar ndërmjetësimin apo duke ju mbështetur atyre, vetëm se ka bërë kufër me unanimitet të dijetarëve.

Llojet e Ndërmjetësimit

Atë që vetëm Allahu ka mundësi ta plotësojë

I mohuar

Është ai ndërmjetësim që Kur'ani e ka mohuar, është ndërmjetësimi që kërkohej prej të tjerëve përveç Allahut për atë që nuk ka mundësi ta realizojë askush përveç Allahut, ky është Shirk i madh (politeizëm).

I pohuar

Është ai që Allahu e ka konfirmuar për Vetën e Tij dhe nuk kërkohet prej askujt tjetër përveç Tij, kushtet e tij janë:

1. Leja e Allahut për ndërmjetësim
2. Që të jetë Allahu i kënaqur me atë që ndërmjetëson
3. Të jetë i kënaqur me atë që ndërmjetësohet për të.

Ndërmjetësim që ka mundësi ta bëjë një krijesë:

Lejohet me katër kushte:

1. Të jetë i pranishëm.
2. Të jetë i gjallë
3. Të ketë aftësinë për të ndërmjetësuar
4. Të besohet se është vetëm shkak për arritjen e synimit.

Ndërmjetësimi specifik i Profetit (ﷺ):

1. Ndërmjetësimi i Madh (në ditën e Gjykimit)
2. Ndërmjetësimi për xhaxhain e tij Ebu Talibin që ti lehtësohet denimi.
3. Ndërmjetësimi i tij për t'u Hapur Portat e Xhenetit.

Ndërmjetësimi i Përgjithshëm i të Dërguarve, Profetëve, Engjëjve, Njerëzve të Teuhidit dhe i foshnjave.

1. Ndërmjetësimi për ngritjen e shkallëve të Besimtarëve.
2. Ndërmjetësimi për ata që e meritojnë xhehenemin prej besimtarët që të mos futen në të (disa prej tyre).
3. Ndërmjetësimi për ata që hyjnë në xhehenem prej besimtarëve që të dalin prej tij.

A është e saktë për një person t'i thotë dikujt tjetër: "Lute Allahun për mua?"

Nëse e lidh zemrën me atë person, atëherë ky është prej llojeve të shirkut të vogël, kurse nëse bëhet me katër kushtet e cekura më lartë (i gjallë, prezentë, i aftë, shkak) atëherë është e saktë edhe pse nuk parapëlqehet.

Teuekuli (mbështetja):

Varësia e vërtetë ndaj Allahut e shoqëruar me lidhje të fortë ndaj Tij, duke mos i anashkaluar shkaqet e ligjëruara.

E Lejuar

Nëse i mbështetet ndonjë të gjalli për çështje për të cilën ai ka mundësi fizike/materiale në realizimin e saj, kjo , duke e konsideruar atë si shkak, me bindje se realizimi është vetëm në dorë të All-llahut, siç është rasti me atë që e autorizon dikë për tregti apo transaksion.

Shirk i Vogël

Është varësia ndaj ndonjë të gjalli duke lidhur zemrën me të, siç është rasti me atë që i varësohet ndonjë të gjalli për rizkun (furnizimin) e tij, duke e bërë atë më shumë se një shkak.

Shirk i madh nëse ia dedikon dikujt tjetër përveç Allahut (këtë e kishte për synim autori)

Mbështetja e plotë në formë adhurimi dhe nënshtrimi, derisa të ketë bindje që mund të sjellë dobi apo largojë dëme, siç është rasti i atyre që ju mbështeten të vdekurve.

A është e saktë të thuhet "ju kam mbështetur filanit", apo "ju kam mbështetur Allahut pastaj ty?"

Asnjëra prej thënieve nuk është e saktë, sepse është një veprim i zemrës dhe nuk duhet ti drejtohet askujt përveç Allahut të madhëruar, mirëpo e sakta është që të thuhet "kam autorizuar filanin"; i Dërguari ﷺ ka autorizuar disa nga shokët e tij për çështje të përgjithshme apo të veçanta.

Kushdo që nuk i bën tekfir (nuk i llogarit l pabesimtarë) mushrikët (idhujtarët), apo dyshon në veprën e tyre të kufrit (mosbesimit), apo e saktëson rrugën e tyre, vetëm se ka bërë kufr.

Cili është gjykimi i Islamit për politeistët?

Kujt do që i arriti Mesazhi i të Dërguarit të Allahut (ﷺ) dhe nuk besoi në të, atëherë ai është jobesimtar, sepse Allahu i lartësuar thotë :

"Kushdo që kërkon fe tjetër përveç islamit ajo nuk do ti pranohet" 3:85

A bëjnë pjesë ithtarët e Librit (çifutë dhe krishterë) tek idhujtarët?

Po, sepse Allahu i lartësuar thotë:

"Luftojini ata që nuk besojnë All-llahun e as ditën e gjykimit, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi All-llahu dhe i dërguari i Tij, dhe nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri (çifutët dhe të krishterët), derisa ta japin xhizjen (taksën) në dorë e duke qenë të përlurur." (9:29)

I Dërguari i Allahut (ﷺ) tha: *"Betohem tek Ai në dorën e të Cilit është shpirti im, ç'do kush prej çifutëve apo të krishterëve që dëgjon për mua dhe pastaj vdes duke mos besuar në atë për të cilën jam dërguar, do të jetë nga banorët e Zjarrit".*

A do të thotë kjo se ne nuk jemi të lejuar që të përmbushim marrëveshjet tona ndaj tyre?

Kushdo që ka bërë ndonjë marrëveshje me ta, duhet ta përmbushë atë për hir të Allahut të Lartësuar, Allahu thotë në Kuran: **"Për sa kohë që ata t'i përmbahen marrëveshjes - përmbajuni edhe ju, sepse Allahu i do të devotshmit" 9:7.** Në lidhje me sjelljen ndaj mushrikinëve (politeistëve/jobesimtarëve), njerëzit mund të kategorizohen në tri grupe:

Prej atyre që marin pjesë në festimet, festivalet dhe praktikimet fetare të tyre.

Prej atyre që bëjnë padrejtësi kundër tyre, siç janë vrasja, vjedhja, dëmtimi i tyre.

Rruga e mesme e ehli sunetit është shmangja nga pjesëmarrja në festimet e tyre. Përmbushja e të gjitha premtimeve dhe angazhimeve dhe mos kryerja e padrejtësive ndaj tyre. Pjesëmarrja me ta në raporte të ndërsjellta si tregtia, etj duke i ftuar ata tek njëshmëria e Allahut.

Anuluesi i KATËRT

Kush beson që ka udhëzim më të plotë se udhëzimi i Profetit (ﷺ), apo që gjykimi i ndokujt është më i mire se sa gjykimi i tij, siç është rasti me ata të cilët preferojnë gjykimin e Tagutëve para gjykimit të tij, atëherë ai është Kafir (mosbesimtarë).

Gjykimi me ligje të tjera përveç asaj çfarë Allahu ka shpallur.

Është preferimi i ligjeve të tjera përveç atyre të ligjëruara nga Allahu, ose besimi se vendimi i Allahut nuk është i dobishëm. Kush përqafon këtë besim, atëherë bën kufër të madh që nxjerr nga Islami, pra bëhet jobesimtar. Allahu (ﷻ) thotë në Kuran: **“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre, si dhe Mesinë, të birin e Merjemes, ndërkohë që janë urdhëruar të adhurojnë vetëm një Zot, përveç të Cilit nuk ka tjetër që meriton të adhurohet. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim).”**(Kur'an 9:31)

Ka prej tyre që besojnë se ligji i Allahut të Lartësuar duhet të zbatohet dhe është më i miri për shoqërinë, por preferojnë legjislacionin tjetër përveç atij të Allahut, për shkak të dëshirave të tyre, dashurisë së tyre për një pozicion, fuqi e kështu me radhë. Në këtë rast ata kanë bërë kufër të vogël (mëkat shumë i madh, por që nuk i nxjerr nga islami sh.p). Nëse përveç kësaj i'a mohon të drejtat dikujt (sipas sheriatit) atëherë ai është gjithashtu shtypës, dhe rrezikon të bjerë në Kufër të madh duke e bërë atë të dalë prej Islamit .

Anuluesi i PESTË

Kushdo që urren ndonjë gjë me të cilën ka ardhur i Dërguari ﷺ edhe nëse vepron me të, vetëm se ka bërë kufr.

Dëshmia për këtë anulues është thënia e Allahut të Lartësuar:

“Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre.” (47:9)

Po ashtu thënia e Tij:

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të binden ty plotësisht.” (4:65)

Dhe thënia e Tij:

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.” (6:125)

Të dashurit dhe të urreyerit për hir të Allahut (ﷻ):

Dashuria dhe urrejtja për hir të Allahut është prej obligimeve, madje është lidhja më e fortë e besimit.

Çfarë duhet dashur për hir të Allahut (ﷻ)?

Veprat	Vepruesit	Kohët	Vendet
Ç’do vepër me të cilën Allahu është i kënaqur, është gjithçka që është ligjëruar në islam, siç është Teuhidi.	Kushdo që praktikon atë që Allahu është i kënaqur, siç janë profetët, të dërguarit, engjëjt, sahabët dhe çdo njësues.	Kohët e caktuara që Allahu i do, siç është Nata e Kadrit, pjesa e tretë e natës.	Vende të veçanta që Allahu i do, siç është Meka dhe Medina.

Çfarë duhet të urrejmë për hir të Allahut(ﷻ)?

Veprat	Vepruesit	Kohët	Vendet
Ç'do veprim që Allahu e urren dhe e refuzon, ajo është çdo gjë që e ka ndaluar Allahu dhe i dërguari i Tij.	Siç janë vepruesit e shirkut, të hiporkizisë dhe djajtë.	Kohë të veçanta që Allahu (ﷻ) i urren, siç është koha kur adhurohet dielli.	Siç janë altaret, apo çdo vend në të cilin praktikohet shirku.

A bëhen gratë mosbesimtare kur ato nuk pajtohen me poligaminë?

Realiteti është se ajo nuk e ka mohuar Sheriatin, mirëpo është ndjenjë e natyrshme që e bën të mos e pëlqejë poligaminë, e kjo është një gjë për të cilën ajo nuk qortohet.

Anuluesi i GJASHTË

Kushdo që tallet me diçka prej fesë së të Dërguarit (ﷺ), shpërblimit të Allahut ose dënimit të Tij, vetëm se ka bërë kufr. Allahu thotë:

“...Thuaj: “A mos vallë me Allahun, shpalljet e Tij dhe të Dërguarin e Tij po talleni?” Mos u shfajësoni! Ju e mohuat fenë, pasi patët besuar...”
(Kur'an 9: 65-66)

Ai që përbuz ose tallet

Kuptimi dhe gjykimi i kësaj çështje:

Të tallesh do të thotë të nënvlerësosh dikë ose diçka, gjykimi për atë që tallet ose fyen është se ai konsiderohet jobesimtar sepse kundërshton të vërtetën dhe mosbesimi i tij është Kufr i madh, i cili ka anuluar Islamin e tij, dhe e bënë të detyrueshme dënimin e tij me Zjarr të Xhehenemit. Përsa i përket atij që është në shoqërinë e dikujt që fyen Allahun (ﷻ) ose të Dërguarit të Tij (ﷺ), atëherë ai duhet që të kundërshtojë atë që thuhet ose ta shmang duke u larguar nga ajo shoqëri në të cilën zhvillohet biseda, ngjashëm me këtë është ai që e transmeton një tallje pa e kundërshtuar atë. Allahu thotë në Kuran:

“Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata, derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit.” (4:140)

Pendimi i tij pranohet me kushtet e mëposhtme:

1. Ta lavdërojë Allahun në mënyrën se si duhet të lavdërohet.
2. Të denoncohet nga tallja që e ka kryer.
3. Të shfaqen shenjat e pendimit të tij, dhe t'i dihet singjeriteti.

Ai që e fyen të Dërguarin (ﷺ), pendimi i tij mund të pranohet midis tij dhe Allahut, mirëpo megjithatë pushtetari duhet ta dënojë për këtë veprim.

Megjithatë, nëse ofendimi i supozuar nuk është i qartë, a zbatohet vendimi me kufr? Qasja e duhur është t'i shpjegohet atij rreziku i fjalimit të tij dhe kështu nëse ai pendohet, atëherë ai duhet të falet, përndryshe rasti i tij duhet t'i referohet Gjykatës islame dhe Dijetarëve të Mëdhenjë.

Sihri (magjia), duke përfshirë magjinë e ndarjes dhe magjinë e bashkimit (divorcit ose lidhjes), kushdo që e praktikon atë ose është i kënaqur me të, ka bërë kufër. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

“Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: “Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues (duke mësuar apo ushtruar magjinë)!” (Kur’an 2:102)

Magjia

Shenjat e atij që praktikon Magjinë

1. Mosndjekja e rrugëve të lejueshme të rukjes.
2. Shkruajtja e fjalëve të ndara, apo fjalëve të pakuptimta.
3. Shikimi në yje, leximi i shuplakës apo filxhanit.
4. Lidhja e nyjeve e shoqëruar me fryerje.
5. Veprimi që të dashurohet apo urrehet dikush.
6. Të urdhërojë të sëmurin që të bëjë ndonjë vepër të ndaluar, siç është lënia e namazit, apo bërja e Kurbanit në emër të dikujt tjetër përveç Allahut.
7. Që të pyes për emrin e nënës.
8. Të pretendojë njohjen e të fshehtës (Gajbit)

Dispozita e saj:

Magjia është kufër i madh, si shkak i thënies së Allahut:

“Këta engjëj (Haruti dhe Maruti) nuk i mësonin ndokujt magji, pa i thënë: Ne jemi dërguar për t’ju vënë në provë, andaj ti mos u bëj mohues”

Shkuarja tek magjistari dhe dispozita për këtë:

Kjo përfshin: vizitën e magjistarit, dërgimi i dikujt tek magjistari në emrin tënd, dërgimi i mesazheve, shikimi i kanaleve televizive apo internetit ku shfaqet horoskopi, leximi i shuplakës, apo filxhanit... Gjykimi i atij që shkon tek magjistarët është se namazi i tij nuk pranohet për 40 ditë, siç është përmendur në hadithin e të Dërguarit të Allahut (ﷺ): **“Ai që viziton një parashikues fati/fallxhor dhe e pyet atë për ndonjë gjë, namazi i tij nuk do të pranohet për 40 ditë”**.

Sa i përket atij që beson në thëniet e magjistarëve, atëherë i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: **“Kushdo që shkon tek një parashikues fati ose fallxhor dhe beson në atë që i thuhet, ai ka mohuar në atë që iu shpall Muhammedit (ﷺ)”**, përjashtim ka për atë që shkon për ta kundërshtuar dhe është i denjë për këtë.

Heqja e efektit të magjisë (النشرة)

Ajo është dy llojesh:

E Lejuar

Është ajo që bëhet me anë të rukjes, apo barërave të lejuara, apo lutjes.

E ndaluar

Nëse ajo përmban lloje magjie, ka thënë i Dërguari ﷺ "Është nga veprimi i shejtanit".

Përgënjeshtrimi i atij që pretendon se lejohet magjia të shërohet me magji:

1. Largimi i magjisë me magji është në kundërshtim me Kuranin, Sunnetin dhe udhëzimin e të parëve tanë të mirë.
2. Bëhet shkak për zëvendësimin e kurimit të vërtetë (me Kur'an dhe Sunet).
3. Në këtë veprim (lejimin e kurimit të magjisë me magji), lejohet rritja e influencës së magjisë dhe magjistarëve në popull.
4. Aty ka largim prej të sigurtës që është shërimi me Kuran, për në të dyshimtën që është largimi i magjisë me magji.
5. Që të prishi magjia magjinë, duhet që si kuruesi ashtu dhe i kuruari ti afrohen djallit me atë që ai pëlqen derisa ta prishi magjinë.
6. Nëse ai i cili është prekur nga magjia duron, atëherë atij do ti takojë Xhenneti siç është transmetuar nga Profeti ﷺ.
7. Largimi i magjisë me magjinë vetëm se ia shton sëmundjen/magjinë pacientit.
8. Profetit ﷺ i është bërë magji, mirëpo nuk është kuruar me magji, por me rukje të ligjshme.

Mbështetja e idhujtarëve dhe ndihmesa e tyre kundër muslimanëve. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

“...Kushdo prej jush që i bën ata miq, është me ata. Vërtet, Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë keqbërësit”.(5:51)

Mbështetja e jobesimtarëve kundër besimtarëve:

Është obligim për çdo musliman të distancohet nga idhujtarët, jobesimtarët dhe të mohoj fenë e tyre dhe të bëjë aleat pasuesit e Teuhidit (Njëshmërisë) dhe ta dojë fenë e tyre, ndërsa, kushdo që e do mosbesimin ose është i kënaqur me të, apo e mbështet atë, apo i ndihmon idhujtarët kundër muslimanëve, atëherë ai ka mohuar dhe është një prej tyre. Si rezultat, mbështetja e politeistëve ose jobesimtarëve kundër muslimanëve bie në dy kategori:

Mosbesim dhe anulim i islamit

Ky është bashkimi me jobesimtarët kundër muslimanëve nga dashuria për jobesimtarët dhe urrejtja për muslimanët, duke dëshiruar fitoren e mosbesimtarëve mbi muslimanët.

Nuk është mosbesim që e anulon Islamin (por është mëkat i madh)

Që të mos jetë kjo me dashuri ndaj idhujtarëve dhe me urrejtje ndaj muslimanëve, por për interesa të kësaj bote dhe për përfitime materiale.

Anuluesi i NËNTË

Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohej të dalin prej legjislacionit islam ashtu siç ju lejua Hidrit dalja prej legjislacionit të Musës ﷺ atëherë ai është një Kafir (Jobesimtarë).

Kushdo që beson që disa njerëzve ju lejohej të dalin prej urdhërave dhe ndalesave të Allahu dhe të Dërguarit të Tij ﷺ

Ai është mosbesimtarë me unanimitetin e dijetarëve, i ofrohet rasti të pendohet dhe i sqarohen faktet, nëse nuk pendohet atëherë dënohet me vdekje nga pushtetari.

Ka thënë i Lartësuar:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا

“Thuaj: “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju...” (7:158)

Dhe ka thënë i Dërguari ﷺ

"Po të ishte vëllai im Musa gjallë, nuk do të kishte zgjedhje përveç të më pasonte."

Aty bëjnë pra pjesë edhe ithtarët e Librit që ju ka arritur shpallja e fundit siç u cek më parë.

Shtrohet pyetja: a është e vërtetë që Hidri ka dal nga sheriatit i Musës ﷺ?

Kjo nuk na është vërtetuar që ai të ketë dal prej tij, por edhe nëse vërtetohet, mbase nuk ka qenë prej Umetit të Musës ﷺ, ngase Profetët e mëparshëm janë dërguar tek popujt e tyre, kurse Profeti ynë ﷺ është dërguar tek të gjithë njerëzit, andaj askujt nuk i takon që të dal prej sheriatit të tij.

Anuluesi i DHJETË

Shmangia nga feja e Allahut duke mos e mësuar atë dhe duke mos vepruar me të. Dëshmi për këtë është thënia e Allahut:

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ ذُكِّرَ بِآيَاتِ رَبِّهِ ثُمَّ أَعْرَضَ عَنْهَا إِنَّا مِنَ الْمُجْرِمِينَ مُنتَقِمُونَ

“Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne hakmerremi ndaj keqbërësve!”

(32:22)

Largimi nga feja e Allahut (🕌)

I Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: *“Kujtdo që Allahu ia dëshiron të mirën, e bën atë të kuptojë Fenë”,* prej kësaj nënkuptohet që atij që Allahu nuk ia dëshiron të mirën (me dëshirë universale), Allahu e largon prej Islamit dhe ai bëhet i pavëmendshëm lidhur me mësimin e fesë së Allahut. Allahu i madhëruar thotë: **“Kush është më i padrejtë se ai që, kur i përmenden shpalljet e Zotit të tij, nuk ua vë veshin atyre? Vërtet, Ne do të hakmerremi ndaj keqbërësve!”** (32:22)

Dhe muxhrimunët (kriminelët, jobesimtarët, politeistët, mëkatarët, mohuesit, etj.) janë prej banorëve të Zjarrit, kërkojmë strehim tek Allahu prej dënimit me Zjarr.

Gjykimi mbi shmangien

Nëse shmanget me dëgjimin dhe zemrën e tij nga i Dërguari i Allahut (ﷺ) as nuk e beson, as nuk e përgënjeshtrohet, as nuk e miqëson, as nuk e armiqëson, dhe nuk i kushton rëndësi asaj me të cilën u dërgua, atëherë ai është një jobesimtar dhe mosbesimi i tij është Kufër i madh, që e nxjerr atë prej Islamit.

Thotë Allahu i Lartësuar:

Kur u thuhet atyre: “Ejani tek ajo që ka shpallur Allahu dhe i Dërguari i Tij” i sheh hipokritët se si largohen prej teje me përbuzje. (4:61)

Po ashtu thënia e Tij:

“Kushdo që largohet prej këshillave të Zotit të Tij, Ai do ta hedhë drejtë një dënimi të ashpër” (72:17)

Nuk ka dallim për kryerjen e ndonjërit prej anuluesve të lartpërmendur, pavarësisht nëse dikush e ka bërë atë seriozisht, me shaka apo nga frika, përveç nëse është i detyruar të thotë ose të bëjë ndonjë prej tyre. Të gjitha ato janë prej çështjeve më të rrezikshme dhe që ndodhin më së shpeshti. I takon një muslimani të jetë i kujdesshëm dhe të ketë frikë se mos bie në njërin prej tyre. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo çfarë e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm. Paqja dhe bekimet qofshin mbi krijesën më të përsosur, Muhammedin (ﷺ) familjen dhe shokët e tij.

Nuk ka dallim tek këta anulues midis atij që:

E bën nga frika:

Është ai që pretendon se e ka bërë këtë anulues të islamit nga frika se mos po i ndodh ndonjë dëmtim, qoftë në pasuri apo pozitë, megjithëse nuk e ka detyruar askush. Allahu (ﷻ) thotë në Kur'an:

“Ka disa njerëz, që thonë: “Ne besojmë Allahun”. Por, kur vuajnë për çështjen e Allahut, e quajnë përndjekjen prej njeriut njësoj si dënimin e Allahut. Ndërsa, kur u vjen fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri - do të thonë: “Ne kemi qenë me ju”. Vallë! A nuk e di Allahu më së miri se ç’ka në zemrat e cdokuit?” (29:10)

E bën seriozisht:

Ai që bën anuluesin seriozisht dhe e kryen qëllimisht dhe nuk ka për këtë ndonjë arsye.

E bën me shaka:

Ai që e bën anuluesin dhe pretendon se ai thjesht ishte duke bërë shaka.

E bën duke qenë i detyruar:

Nuk bën kufër ai i cili e vepron ndonjërin prej anuluesve të islamit nëse vërtetë është detyruar. kushtet që e bëjnë arsyetimin e vlefshëm janë si më poshtë :

1. Të jetë vërtet i detyruar ta kryejë atë, nuk ka arsyetim për atë që nuk është detyruar, siç është i frikësuar, apo ai që bën lajka.
2. Ai nuk duhet të tejkalojë këtë shkelje; për shembull: nëse ai detyrohet të fyej dikë fyerja e të cilit është kufër dhe shkon përtej kësaj dhe fyen të tjerë përveç tij atëherë ka bërë kufër.
3. Të mundohet sa të ketë mundësi të mos jetë ajo e drejtpërdrejtë, por shprehje që aludon në më shumë se një kuptim.
4. Zemra e tij duhet të jetë e kënaqur me besimin, kjo do të thotë që ai duhet të ketë besim në zemrën e tij, ndërkohë që shqipton atë që është i detyruar të thotë.
5. Ajo që ai është i detyruar të thotë, nuk duhet të jetë një shkelje ndaj të tjerëve, as nuk duhet të jetë një devijim për njerëzit e tjerë.

SQARIME TË RËNDËSISHME

Së pari: Autori, me shkrimin e këtij libri, nuk ka synuar bërjen tekfir (të shpallë jobesimtar) të Umetit (muslimanëve), por synimi i tij ishte t'i mësojë njerëzit në mënyrë që të kenë kujdes prej këtyre anuluesve dhe të kenë frikë prej tyre, sepse kur të kenë frikë prej tyre atëherë besimi i tyre do të jetë i saktë dhe do të shpëtojnë nga dënimi i dhembshëm, ashtu siç ju takon atyre që edhe të tjerët ti paralajmërojnë nga ato, sepse ai është rrezik i madh që duhet të mësohet në mënyrë që të ruhet prej tij.

Së dyti: Frika e muslimanit prej shirkut bëhet duke e mësuar diturinë e pastër fetare, i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë: "*Kujtdo që Allahu ia dëshiron të mirën, Allahu e bën atë të kuptojë Fenë*". Andaj, kuptimi i fesë është nga obligimet më të rëndësishme dhe më të mëdha, përmes saj njeriu e mbron veten nga shirkun, risitë dhe mëkatet, sa më shumë që njeriut i shtohet njohuria për Zotin e tij kjo e bën që të ketë më shumë parasysh mbikëqyrjen e Tij për fjalët dhe veprat e tij, dhe sa më shumë që njeriu ngritet në dituri, aq më shumë i shtohet sinqeriteti ndaj Allahut dhe i plotësohet besimi, kanë thënë disa dijetarë: "Ne kërkuam diturinë për dikë tjetër përveç Allahut, por refuzojë dituria që të jetë vetëm për hir të Allahut".

Së treti: Nuk lejohet bërja tekfir një person të caktuar, vetëm pasi të vërtetohet që ka rënë në një nga anuluesit e Islamit, ti ngritet argumenti dhe të largohen pengesat e tekfirit, ai i cili e veçron këtë është vetmi person që është është gjykatësit ose dijetarët islam, sa i përket publikut të gjerë, nuk u lejohet atyre të përfshihen në këto çështje.

Së katërti: Autori e përfundon librin e tij me lutjen e mëposhtme: "Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga ajo çfarë e bën të detyrueshëm hidhërimin e Tij dhe dënimin e Tij të dhembshëm", kjo lutje reflekton qëllimin e tij të mirë, butësinë e tij ndaj lexuesit. Ky është një zakon i tij në të gjitha shkrimet e tij. Allahu e faltë e mëshiroftë dhe i dhëntë atij një shpërblim bujar.

TESTOJE VETEN:

Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

1. Pse dijetarët fillojnë librat e tyre me Bismilah (Emrin e Allahut)?

 2. Cili është kuptimi i anuluesve të Islamit?

 3. Pse dijetarët përdorin shprehje të ndryshme si: Neuakid, Mufsidat, Muhtilat (Zhdukës, zhvlerësues ose anulues)?

 4. A ka dallim në mendime midis dijetarëve në lidhje me këta anulues?

 5. A janë këta anulues të kufizuar me ndonjë numër?

- Përse autori (Allahu e mëshiroftë) thotë: "Janë dhjetë"?

6. Nëse numri përmendet në Kur'an apo Sunnet, a do të thotë se ai ka një nënkuptim, pra nuk mund të shtohet? Apo jo?

.....

.....

.....

.....

7. Pse është numri i përmendur ndonjëherë dhe nuk ka nënkuptim për përmendjen e tij?

.....

.....

.....

.....

8. Jepni një shembull të numrit të përmendur që ka një nënkuptim?

.....

.....

9. Jepni një shembull të numrit të përmendur që nuk ka nënkuptim?

.....

.....

10. A e sheh autori që ka më shumë se dhjetë anulues?

.....

.....

11. Prej cilave fjalë të autorit kuptohet se ai e sheh që ka më shumë se dhjetë anulues?

.....

.....

.....

.....

12. A është e mundur të përmbliidhen zhvlerësuesit/Anuluesit?

.....

.....

.....

13. Si mund të përmbliiden Anuluesit?

.....

14. Pse i mësojmë Anuluesit?

.....

15. A ka shkruar ndonjë autor tjetër, përveç këtij autori, në lidhje me këtë çështje?

.....

16. A ka dallim kur diskutojmë Neuakid (Anuluesit) mes veprës dhe vepruesit?

.....

17. Cila është arsyeja për bërjen e dallimit?

.....

18. A është synimi i autorit me këta anulues që të bëjë Tekfir personat?

.....

19. Çfarë duhet të veprojë ai i cili i mëson këto anulues?

.....

.....

.....

.....

20. Cilin lloj të shirkut e kishte për qëllim autori?

.....

.....

.....

.....

21. Si mund të bëjmë dallimin mes Shirkut të madh dhe Shirkut të vogël?

.....

.....

.....

.....

22. A pranohet pendimi i atij që kryen Shirk të madh? Dhe kur nuk i pranohet pendimi?

.....

.....

.....

.....

23. Ç'farë është më e keqe: Shirku i vogël apo mëkatet e mëdha?

.....

.....

24. Me ç'farë koncepti mund ti dallojmë mëkatet e mëdha?

.....

.....

.....

.....

25. A janë mëkatet e mëdha të kufizuara në një numër të caktuar?

.....

.....

26. Cili është gjykimi për personin që kryen mëkate të mëdha, a duhet apo urrehet?

.....

.....

.....

.....

27. A lejohet të shoqërosh atë që kryen një mëkat të madh?

.....

.....

28. A janë mëkatet e mëdha të klasave të ndryshme? Cili është argumenti?

.....

.....

.....

.....

29. A mund të falen mëkatet e mëdha nëpërmjet veprave të mira? Apo duhet pendim për to?

.....

.....

30. Cilat janë kategoritë e veprimeve të ndaluara?

.....

.....

.....

.....

31. Cilat janë llojet e Shirkut të madh?

.....

.....

.....

.....

32. Cilat janë llojet e ndalesave?

.....

.....

.....

.....

33. Cilat janë llojet e shirkut të madh?

.....

.....

.....

.....

34. Cilat janë llojet e Kurbanit?

.....

.....

.....

.....

35. Në cilat raste theërja e Kurbanit llogaritet prej shirkut të madh?

.....

.....

36. Cilat janë llojet e ndërmjetësimeve?

.....

.....

.....

.....

37. Çfarë është Teuekuli (mbështetja tek Allahut)?

.....

.....

38. Cilat janë kategoritë e Teuekulit?

.....

.....

.....

.....

39. A është e saktë të thuhet: ju kam mbështetur filan personit, apo të thuhet ju kam mbështetur Allahut pastaj filanit?

.....

.....

.....

.....

40. Çfarë duhet të thotë?

.....

.....

.....

.....

41. Cila është dëshmia e mosbesimit të idhujtarëve dhe a përfshihen aty ithtarët e Librit?

.....

.....

.....

.....

42. A do të thotë kjo se nuk duhet t'i përmbushim marrëveshjet tona me ta?

.....

.....

.....

.....

43. Cilat janë kategoritë e muslimanëve në raport me ata që kanë marrëveshje?

.....

.....

.....

.....

44. Cilat janë llojet e mosgjykimit me ligj të Allahut?

.....

.....

.....

.....

45. Cili është gjykimi në lidhje me dashurinë për hir të Allahut?

.....

.....

.....

.....

46. Kë duhet ta duam për hir të Allahut? Dhe kë duhet ta urrejmë për hir të Allahut?

.....

.....

.....

.....

47. Çfarë lloji kufri (mosbesimi) është tallja me fenë?

.....

.....

48. A ka pendim për atë që tallet me fenë? Dhe cilat janë kushtet e pendimit të tij?

.....

.....

.....

.....

49. Cili është gjykimi i sharjes së Profetit (ﷺ)?

.....

.....

.....

.....

50. Cili është gjykimi për atë e dëgjon këtë sharje?

.....

.....

51. Cili është argumenti që aludon për mosbesimin e magjistarit?

.....

.....

.....

.....

52. Cilat janë shenjat e magjistarit?

.....

.....

.....

.....

53. Cili është gjykimi në lidhje me shkuarjen tek magjistari?

.....

.....

54. Ç'farë përfshihet në shkuarjen tek magjistari?

.....

.....

.....

.....

55. Cilat janë mënyrat e ndryshme të shërimit të magjisë?

.....

.....

.....

.....

56. Si mund ta kundërshtojmë atë që thotë se mund ta heqim magjinë me magji?

.....

.....

.....

.....

.....

57. Cili është gjykimi për mbështetjen e mushrikëve?

.....

.....

.....

.....

58. A është e lejuar që dikush ta braktisë Sheriatin e Muhamedit (ﷺ)?

.....

.....

59. A ka dalë Hidri prej sheriatit të Musait (alejhi selam)?

.....

.....

60. Cili është gjykimi për atë që shmanget nga feja e Allahut duke mos e mësuar apo praktikuar atë?

.....

.....

.....

.....

61. Ç'farë kishte për qëllim autori me "të frikësuarin" dhe se a llogaritet ai të jetë i detyruar?

.....

.....

.....

.....

62. Cilat janë kushtet e detyrimit?

.....

.....

.....

.....

63. Cila ishte urtësia e përfundimit të librit me atë lutje specifike?

.....

.....

.....

.....

64. Ç'farë masash paraprake duhet të mari një musliman kundër shirkut?

.....

.....

.....

